



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
në “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interior
Universiteti New York-ut në Tiranë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Etleva Dobjani, Prof. Assoc. PhD

2. Etleva Bushati, Dr.

Tetor/ 2024

**Tabela përmbledhëse për programin e Studimit të Ciklit të Parë Bachelor
në “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë (UNYT)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i “Arkitekturës dhe Dizajnit”
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Dizajn” me dy profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Nr. 235 dt. 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim per herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	3 vite /6 simestra
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht/
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6-të
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	(2021-2022) 7 PAE/ 1 PAK (2022-2023) 12 PAE/ 5 PAK (2023-2024) 18 PAE/ 9 PAK
18	Numri i studentëve:	(2021-2022) - 13 (2022-2023) - 17 (2023-2024) - 28
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimeve Bachelor në “Dizajn” me dy profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interior” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i New York-ut (UNYT)” është thelbësor për të siguruar cilësinë dhe përputhshmërinë e tij me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ky proces përfshin disa faza kyçe dhe angazhon një sërë aktorësh, duke përfshirë ekspertë të jashtëm, stafin akademik të universitetit, studentët dhe palët e interesuara.

Faza e Përgatitjes: Institucioni përgatit një raport të detajuar vetëvlerësimi, i cili përmban informacion të gjithanshëm mbi programin, duke përfshirë kurrikulën, metodat e mësimdhënies, kualifikimet e stafit akademik, infrastrukturën, rezultatet e mësimin dhe mundësitë e karrierës për absolventët. Ky raport gjithashtu adreson sfidat dhe planet e përmirësimit.


Vizita e Ekspertëve të Jashtëm: Një panel ekspertësh të jashtëm, përbërë nga akademikë dhe profesionistë të fushës së arkitekturës dhe dizajnit, viziton institucionin për të vlerësuar programin bazuar në raportin e brendshëm të vlerësimit dhe për të mbledhur të dhëna shtesë përmes intervistave me stafin akademik, studentët dhe palët e interesuara. Ata gjithashtu inspektojnë infrastrukturën dhe resurset e disponueshme.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm: Pas vizitës, paneli i ekspertëve harton një raport vlerësimi që përmban vëzhgimet, gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Ky raport trajton aspekte të tilla si përputhshmëria e kurrikulës me objektivat e programit, efektiviteti i metodave të mësimdhënies, cilësia e punës së studentëve, kualifikimet e stafit akademik dhe mbështetja për studentët.

Plani i Veprimit dhe Përmirësimit: Bazuar në rekomandimet e raportit të vlerësimit të jashtëm, institucioni zhvillon një plan veprimi për të adresuar çështjet e ngritura dhe për të përmirësuar cilësinë e programit. Ky plan përfshin afate kohore dhe përgjegjësitë specifike për zbatimin e masave përmirësuese.

Monitorimi dhe Rishikimi: Institucioni, në bashkëpunim me organet rregullatore të arsimit të lartë, monitoron zbatimin e planit të veprimit dhe bën rishikime periodike për të vlerësuar efektivitetin e masave të ndërmarra dhe për të siguruar që programi vazhdon të përmbushë standardet e cilësisë.

Procesi i vlerësimit të jashtëm është jetik për të garantuar që programi i Bachelorit në “Dizajn” i ofruar nga “Universiteti i New York-ut (UNYT)” jo vetëm që plotëson kërkesat akademike dhe profesionale të fushës, por edhe përgatit studentët në mënyrën më të mirë të mundshme për sfidat e tregut të punës dhe për të kontribuar në shoqëri në mënyrë kreative dhe inovative.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Dizajn” në Universitetin e New York-ut në Tiranë (UNYT) synon të ofrojë një paraqitje të qartë dhe transparente të funksionimit të programit dhe njësive kryesore përgjegjëse për të. Ky proces synon të promovojë një kulturë të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë, si dhe të ndihmojë në ngritjen e cilësisë së programit të studimit.

Për përgatitjen e këtij raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ)

1. **Etleva Dobjani**, Prof. Assoc. PhD

2. **Etleva Bushati**, Dr.

është mbështetur në dokumentet e ofruara nga UNYT në portalin e ASCAL, gjatë periudhës mars-prill 2024. Kordinatorë teknike ishte Anilda Beqiraj Msc.

Procesi është zhvilluar në disa faza kryesore:

- Shqyrtimi i standardeve nga RVB-ja.
- Shqyrtimi i evidencave të ofruara nga institucioni.
- Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Konkluzionet e arritura gjatë këtij procesi reflektojnë mendimet e anëtarëve të GVJ-së, të analizuara dhe argumentuara mbi bazën e standardeve dhe kritereve të përcaktuara. Për të arritur në këto konkluzione, GVJ ka realizuar vizita në institucion dhe takime me zyrat përkatëse, pedagogët, studentët e programit të studimit në “Dizajn” me dy profile, “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interior”, si dhe përfaqësues të njësive dhe strukturave të tjera të përfshira.

Ky raport paraqet në mënyrë objektive situatën aktuale të zhvillimit të këtij programi studimi dhe GVJ beson se informacioni i dhënë do të ndihmojë bordin e akreditimit të marrë një vendim të drejtë dhe të paanshëm.


Universiteti , është njohur me DRVJ më datë 07.10.2024, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 05/34 Prot date 07.10.2024. UNYT nuk ka komente, dërguar këto me shkresën Nr 223/2024 Prot , datë 09.10.2024 . Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si RVJ.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE


Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimeve në Dizajn, i ofruar nga Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit në Universitetin Ndërkombëtar të Tiranës (UNYT), është në harmoni me interesat kombëtare dhe nxit vlerat akademike e kulturore të vendit. Ky program synon të përmbushë nevojat e tregut vendas të punës, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik, përmirësimin e cilësisë së jetës, estetikën e hapësirave të jetesës dhe vlerave artistike, promovimin e identitetit kulturor dhe krijimin e një mjedisi inovativ. Ai luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e imazhit të bizneseve dhe markave, duke shtuar vlerë në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar. Programi inkurajon inovacionin dhe kreativitetin, duke përmirësuar jetën kulturore dhe ekonominë e vendit. Bazuar ne: Aneksi 1.1 Statuti i UNYT Aneksi 1.7 Rregullorja e Universitetit Aneksi 1.8 Rregullore Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës Aneksi 1.9 Rregullore Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit Aneksi 1.10 Rregullorja e Programit Dizajn
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit në Dizajn në Universitetin e New York-ut në Tiranë përputhet me misionin e universitetit. Kërkesa për dizajnerë grafikë dhe interieri po rritet në Shqipëri për shkak të zhvillimit të bizneseve, startup-eve dhe sektorit të shërbimeve kreative. Marketingu online dhe prezantimet vizuale cilësore kanë rritur rëndësinë e dizajnerëve grafikë. Zhvillimi i industrisë së ndërtimit dhe preferencat e konsumatorëve kanë shtuar kërkesën për dizajnerë interieri. Tregu i mobiljeve dhe ndikimi i mediave sociale kanë ndihmuar në rritjen e kësaj kërkesë. Përmirësimi i estetikës dhe komfortit ka bërë që gjithnjë e më shumë njerëz të kërkojnë shërbimet e profesionistëve të dizajnit. Aneksi 1.10 Rregullorja e Programit Dizajn, Neni 6, fq. 4-6
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi Bachelor në Dizajn, me profile në Dizajn Grafik dhe Dizajn Interieri, organizohet sipas Ligjit Nr 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe rregulloreve të Universitetit të New York-ut në Tiranë (UNYT). Ky program përputhet me objektivat strategjike, misionin dhe vizionin e UNYT, duke respektuar strategjinë e zhvillimit dhe rregulloret e universitetit. Programi pajis studentët me aftësi dhe kompetenca të nevojshme për të qenë konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe për të ndjekur studime të mëtejshme akademike.



	<p>UNYT garanton lirinë akademike në mësimdhënie, mësimnxënie, inovacion dhe aktivitete krijuese, duke synuar cilësinë maksimale në fushat e tij akademike. Programi është hartuar në përputhje me drejtimet akademike të institucionit.</p> <p>Aneksi 1.1 Statuti</p> <p>Aneksi 1.6 Plani Strategjik i UNYT 2020-2025</p> <p>Aneksi 1.7 Rregullorja e Universitetit</p> <p>Aneksi 1.10 Rregullore e Programi Bachelor në Dizajn, Neni 1, Neni 6 .</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Personeli i angazhuar për të dhënë leksione përbëhet nga staf akademik vendas dhe i huaj, të cilët vijnë nga fusha të ndryshme ekspertize. Aktualisht, shumica e stafit të departamentit ka ekspertizë kryesisht në fushën e arkitekturës, por gjithashtu përfshin ekspertë në dizajnin grafik dhe dizajnin e interiorit, të cilat janë thelbësore për këtë program.</p> <p>Aneksi 2.3: CV-të e Personelit Akademik</p> <p>Institucioni disponon bazën materiale minimale për dizajn (Aneksi 3.11: Liçensat për software), duke ofruar laboratorë të pajisur me programe si Rhino, Adobe Creative Suite (Illustrator, Photoshop, InDesign, Premier, AfterEffects), dhe programe të tjera të përdorura në fushën e dizajnit grafik. Të gjithë laboratorët kompjuterikë janë të pajisur me mjete dhe programe profesionale që lejojnë pedagogët të realizojnë me sukses seanca praktike.</p> <p>UNYT gjithashtu ka dy atelie krijuese ku studentët punojnë mbi projektet e tyre, të pajisura me tavolina të mëdha pune dhe dritare të gjera që ofrojnë ndriçimin e nevojshëm, duke krijuar kushte optimale për vizatimin, punimin dhe prezantimin e projekteve. Laboratori i modelimit (Creative Lab 2) është i pajisur me një makineri për prerjen e materialeve për makete.</p> <p>Aneksi 4.12: Sipërfaqja në funksion të mësimdhënies East</p> <p>UNYT investon në zhvillimin dhe përmirësimin e lehtësirave të IT-së për të ofruar teknologjitë më të fundit për studentët dhe personelin akademik, duke transformuar klasat në "klasa të zgjuara" me projektorë LCD dhe ekrane projeksioni, lidhje për laptopë dhe sisteme fonike.</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>Fusha e programit të studimit Bachelor në Dizajn me profilet "Dizajn Grafik" dhe "Dizajn Interieri" është në përputhje me standardet dhe udhëzimet evropiane për arsimin e lartë, të përcaktuara nga Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit. Ky departament, pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, mbulon këto disiplina të rëndësishme të dizajnit.</p> <p>Programi i studimit është krijuar bazuar në klasifikimin dhe kodifikimin e programeve sipas direktivave kombëtare dhe evropiane. Kohëzgjatja e programit është 3 vite akademike, duke përfshirë gjithsej 180 kredite ECTS.</p>

direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Aneksi 1.1.1: Organigrama e UNYT Aneksi 1.4: Kodifikimet Nr. Prot. 55 Aneksi 1.8: Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës Aneksi 1.9: Rregullore e Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit Aneksi 1.10: Rregullore e Programit Dizajn			
Konkluzione	Konkluzione mbi Programin Bachelor në Dizajn me profil “Dizajn grafik” dhe “Dizajn interieri” <ul style="list-style-type: none"> • Programi ka kapacitetin të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike, për t'i bërë ata të aftë dhe konkurrues në fushën e dizajnit. • Studentët zhvillojnë aftësi dhe kreativitet të nevojshëm për të kontribuar në fushën e dizajnit, për t'u përgatitur për sfidat e tregut të punës lokal dhe ndërkombëtar. • Studentët fitojnë njohuri të avancuara dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve komplekse, duke treguar ekspertizë dhe inovacion. • Aftësi në menaxhimin e veprimtarive dhe projekteve komplekse teknike ose profesionale, dhe përgjegjësi për zhvillimin profesional të individëve apo grupeve. • Programi ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe imazhin e bizneseve dhe markave. • Përbush nevojat e tregut dhe shton vlerë në tregun vendas dhe ndërkombëtar. • Departamenti ka burimet njerëzore të specializuara në fushat e reja të dizajnit, si dizajni UX/UI, grafika në lëvizje, animacion, etj. (Aneksi 2.3 CV e Personelit Akademik.pdf.pdf) 			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e	UNYT mundëson marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit duke ndarë detyrat mes njërive dhe personelit për të siguruar për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. Ky institucion ben te mundur identifikimin e problematikave dhe adresimin e tyre për te përmirësuar cilësinë e programeve dhe duke siguruar që ato përputhen me standardet e nevojshme akademike dhe profesionale, përmes monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm nëpërmjet NJSBC-se.



<p>personelit, marrjes së përgjegjëseve përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>NJSBC analizon punën e personelit dhe njësitë të ndryshme dhe siguron që programi i studimit të jetë në zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm brenda mundësive ligjore. Përmes vlerësimit të kujdesshëm të performancës, institucioni mund të identifikojnë zonat ku nevojiten përmirësime dhe të ndërmerren veprime për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e programeve të tyre të studimit si dhe për ti administruar ato sa më mire.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Aktualisht, institucioni ka shumë marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht, ka 66 marrëveshje MoU kombëtare dhe 51 marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtare ose Erasmus+, me disa të tjera në proces. Në funksion të programeve të studimit, UNYT ka zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve duke përfshirë studio projektimi dhe agjenci reklamash që operojnë në fushën e dizajnit.</p> <p>Aneksi 1.29: Lista e Marrëveshjeve Ndërkombëtare Aneksi 5.10: Lista e MoU</p> <p>g Që nga viti 2018, UNYT është pjesë e rrjetit ndërkombëtar të shkollave MAARIF, i cili operon në 67 shtete me 440 institucione edukimi (maarifschools.org/dunyada-maarif).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Universiteti bashkëpunon ngushtë me institucionet arsimore të njohura brenda dhe jashtë vendit. Në degën e Dizajnit, veçanërisht, theksohet bashkëpunimi me Arkivin e Filmit dhe marrëveshja me Universitetin e Arteve për organizimin e leksioneve të hapura dhe workshopeve të përbashkëta. Po ashtu, ka projekte kërkimore të përbashkëta, siç është rasti me Universitetin Yildiz në Turqi, dhe aplikime për projekte bilaterale, si në rastin e Kolegjit AAB në Prishtinë.</p> <p>UNYT ka zgjeruar bashkëpunimin edhe me sektorin e biznesit për të ofruar praktikë profesionale, mundësi internshipi dhe punësimi, vizita në kompani dhe pjesëmarrje në Panairin e Karrierës. Lista e partnerëve përfshin biznese dhe institucione të njohura në Shqipëri, si dhe institucione publike.</p> <p>Aneksi 1.19: Bashkëpunime me institucione arsimore Aneksi 1.13: Workshop 2021-24 Aneksi 1.29: Lista e Marrëveshjeve Ndërkombëtare Aneksi 5.10: Lista e MoU</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësitë përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Zyra e Karrierës në bashkëpunim me njësinë bazë harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për cdo program studimi.</p> <p>Aneksi 1.25 UNYT DAD Raporti i Intership Aneksi 1.26 Raporti i Internshipit M. Dusha</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Universiteti i New York-ut në Tiranë (UNYT) bashkëpunon në mënyrë aktive me sektorin e biznesit dhe institucione arsimore brenda dhe jashtë vendit. UNYT ka forcuar lidhjet me sektorin e biznesit për të ofruar</p>

	praktikë profesionale për studentet e programit Dizajn me dy profilet, mundësi internshipi dhe punësimi, vizita në kompani dhe pjesëmarrje në Panairin e Karrierës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programet e studimit janë të organizuara në lëndë dhe module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit janë përcaktuar në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi parashikon 60 ECTS në vit dhe 180 ECTS në total për 3 vite (Aneksi 1.10, Rregullorja e programit, Neni 6, Neni 16 / Aneksi 1.3, Plani mësimor-kurrikula e programit Bachelor në Dizajn).
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një	Objektivat e programit të studimit përcaktojnë qartazi specilitetin e fushës së studimit si dhe aftësitë dhe kompetencat profesionale që studenti do të përftojë në përfundim të studimeve Aneksi 1.10 Rregullore Programi Programi Bachelor në "Dizajn" ofron dy profile: "Dizajn Grafik" dhe "Dizajn Interieri". Lëndët kryesore për "Dizajn Grafik" përfshijnë Tipografi, Dizajni i Markave, Dizajni i Identitetit të Korporatës, dhe Animacion 2D dhe 3D. Për "Dizajn Interieri", lëndët përfshijnë Dizajn Interieri I-IV, Dizajn Kompjuterik, dhe Komunikim nëpërmjet Dizajnit Grafik. Rreth 14% e lëndëve janë plotësisht teorike, ndërsa 50% kombinojnë teori dhe praktikë për të prodhuar projekte përfundimtare. Aneksi 1.3 Plani mësimor-kurrikula e programit Bachelor në Dizajn

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

fushë të specializuar studimi ose profesionale.																																											
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në programin e studimit, për çdo lëndë dhe modul është përcaktuar veprimtaria formuese A, B, C, D, E dhe lëndët janë grupuar në module sipas kategorive të tyre me një ngarkesë të përshtatshme në kredite.</p> <p>Kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn është në përputhje të plotë me kriteret e VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar), dhe e cila i ndan lëndët në pesë kategori (A, B, C, D, dhe E) dhe VKM nr. 879, datë 18.12.2019.</p> <table border="1" data-bbox="635 654 1423 936"> <thead> <tr> <th colspan="3">Dizajn Grafik</th> </tr> <tr> <th>Kategoria</th> <th>ECTS</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Kategoria A</td> <td>34</td> <td>18.89</td> </tr> <tr> <td>Kategoria B</td> <td>92</td> <td>51.11</td> </tr> <tr> <td>Kategoria C</td> <td>22</td> <td>12.22</td> </tr> <tr> <td>Kategoria D</td> <td>24</td> <td>13.33</td> </tr> <tr> <td>Kategoria E</td> <td>8</td> <td>4.44</td> </tr> </tbody> </table> <table border="1" data-bbox="635 967 1423 1249"> <thead> <tr> <th colspan="3">Dizajn Interior</th> </tr> <tr> <th>Kategoria</th> <th>ECTS</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Kategoria A</td> <td>36</td> <td>20.00</td> </tr> <tr> <td>Kategoria B</td> <td>92</td> <td>51.11</td> </tr> <tr> <td>Kategoria C</td> <td>26</td> <td>14.44</td> </tr> <tr> <td>Kategoria D</td> <td>18</td> <td>10.00</td> </tr> <tr> <td>Kategoria E</td> <td>8</td> <td>4.44</td> </tr> </tbody> </table> <p>Aneksi 1.3 Plani mesimor-kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn Aneksi 2.1 Tabelat përmbledhese, tab. 9</p>	Dizajn Grafik			Kategoria	ECTS	%	Kategoria A	34	18.89	Kategoria B	92	51.11	Kategoria C	22	12.22	Kategoria D	24	13.33	Kategoria E	8	4.44	Dizajn Interior			Kategoria	ECTS	%	Kategoria A	36	20.00	Kategoria B	92	51.11	Kategoria C	26	14.44	Kategoria D	18	10.00	Kategoria E	8	4.44
Dizajn Grafik																																											
Kategoria	ECTS	%																																									
Kategoria A	34	18.89																																									
Kategoria B	92	51.11																																									
Kategoria C	22	12.22																																									
Kategoria D	24	13.33																																									
Kategoria E	8	4.44																																									
Dizajn Interior																																											
Kategoria	ECTS	%																																									
Kategoria A	36	20.00																																									
Kategoria B	92	51.11																																									
Kategoria C	26	14.44																																									
Kategoria D	18	10.00																																									
Kategoria E	8	4.44																																									
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Plani mesimor i programit Bachelor në "Dizajn" ka të përcaktuara kreditet për realizimin e praktikës profesionale, intership 4 ECTS dhe për detyrimet e përfundimit të studimeve, Diploma - 8 ECTS.</p> <p>Aneksi 1.3 Plani mesimore</p>																																										
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të</p>	<p>“Universiteti i New York-ut (UNYT) ” nuk është një institucion i arsimit të lartë me status të veçantë. Pranimi në programin e studimit është i mundur për çdo kandidat i cili ka përfunduar me sukses Arsimin e Mesëm dhe plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me nenin 74 të ligjit Nr. 80/2015, në Ligjin për Arsimin e Lartë. Pranimi i studentëve kryhet sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kriterëve shtesë universitare në Republikën e Shqipërisë.</p>																																										

ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Për më tepër, UNYT pranon edhe studentë me nënshtetësi të huaj duke ndjekur procedurat e njohjes së diplomës dhe ekuivalentimit, sipas legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi. Aneksi 1.10 Rregullore Programi, Neni 7, 8
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	N/A
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Përkatësisht Programi Bachelor në Dizajn me profil "Dizajn Grafik" mban kodin 63BA0211A, dhe Programi Bachelor në Dizajn me profil "Dizajn Interier" mban kodin 63BA0212A.
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i Studimit Bachelor në "Dizajn" nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendas apo të huaj.
Konkluzione	Kurrikula e propozuar për hapjen e programit BACHELOR në DIZAJN me dy profile: Bachelor në Dizajn me profil Dizajn Grafik, dhe Bachelor në Dizajn me profil Dizajn Interier është organizuar në përputhje të plotë me: Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/15, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar si me poshtë) "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 879, datë 18.12.2019, ku përcaktohen elementet e një programi studimi: kreditet ECTS, kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, rezultatet e të nxënit dhe kompetencat profesionale, veprimtaritë formuese dhe komponentet mësimore, kategoritë e veprimtarive formuese, plani mësimor, syllabuset, etj. Kurrikula është në përputhje me kriteret ligjore dhe programi përcakton një ngarkesë të përshtatshme në kredite për lëndë dhe module. Ky strukturim i qartë ndihmon studentët

	të ndjekin progresin e tyre dhe të planifikojnë studimet e tyre në mënyrë efikase.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2																																																																			
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.																																																																			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																		
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit pranë Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, i cili është njësia përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Dizajn" me profile "Dizajn Grafik" dhe Dizajn Interieri", përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, si dhe numrin e titujve dhe gradave të stafit akademik. Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit ka në përbërje të tij një total prej 10 (dhjetë) anëtarësh të punësuar me kohë të plotë si personel akademik. Nga këta anëtarë, shtatë prej tyre kanë së paku gradën shkencore doktor (Dr./PhD). Ky departament mbështetet nga personeli ndihmës akademik të IAL-së, i cili ndihmon në zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve akademike.																																																																		
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="3">Titulli</th> <th colspan="6">Stafi akademik për programin e studimit</th> </tr> <tr> <th colspan="2">(2021 - 2022)</th> <th colspan="2">(2022 - 2023)</th> <th colspan="2">(V2023 - 2024)</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td></td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td></td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>4</td> <td>0</td> <td>7</td> <td>1</td> <td>7</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc (ne proces Dr)</td> <td>2</td> <td>0</td> <td></td> <td>0</td> <td></td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>3</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td></td> <td>7</td> <td>2</td> <td>9</td> <td>6</td> <td>10</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table>							Titulli	Stafi akademik për programin e studimit						(2021 - 2022)		(2022 - 2023)		(V2023 - 2024)		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	0	0	1	0		0	Prof. Asoc.	0	0	0	0		0	Dr/Phd	4	0	7	1	7	2	Msc (ne proces Dr)	2	0		0		0	Msc	1	2	1	5	3	7		7	2	9	6	10
Titulli	Stafi akademik për programin e studimit																																																																		
	(2021 - 2022)		(2022 - 2023)		(V2023 - 2024)																																																														
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																													
Prof. Dr	0	0	1	0		0																																																													
Prof. Asoc.	0	0	0	0		0																																																													
Dr/Phd	4	0	7	1	7	2																																																													
Msc (ne proces Dr)	2	0		0		0																																																													
Msc	1	2	1	5	3	7																																																													
	7	2	9	6	10	9																																																													
Aneksi 2.1 Tabela Personeli Akademik Bachelor ne Dizajn 2021-2024																																																																			
Po ashtu, edhe nga vizita në institucion dhe takimi me zyren e burimeve njerezore, si dhe kontrolli random i dokumentacionit (dosjet e stafit) të zyrës së burimeve njerezore, rezulton se struktura akademike e departamentit përmbush detyrimet ligjore.																																																																			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin	Bazuar në rregulloren e Programit të studimit, departamenti ka përcaktuar angazhimin e personelit ndihmës akademik dhe administrativ për realizimin e praktikave mësimore. Kjo përfshin krijimin e mundësive për studentët që të kryejnë praktikën profesionale pranë studiove, kompanive, apo institucioneve me të cilat departamenti																																																																		

në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	ka marrëveshje bashkëpunimi. Këto marrëveshje janë specifikuar në Aneksin 4.14 të Manualit të Politikave të Sigurisë . Studentët konfirmojnë gjate vizites ne institucion se janë të informuar nga Departamenti dhe ndihmohen nga pedagogët për realizimin e praktikave mësimore. Ky ndihmë përfshin informacionin dhe orientimin e nevojshëm gjatë vizitave në institucione, takimeve me studentët dhe alumni-t, duke siguruar që të gjitha palët të jenë të mirëinformuara dhe të përgatitura për të përfituar maksimalisht nga përvoja praktike profesionale.								
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në programin Bachelor në “Dizajn” me profil “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri”, drejtuesi i departamentit është personi përgjegjës për koordinimin e programit, për mbarëvajtjen akademike të departamentit, duke i’u referuar miratimit të silabuseve, së bashku me dekanin. Aneksi 1.1 Statuti i UNYT, Neni 24								
Konkluzione	Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit, pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, është njësia përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Dizajn" me profilet “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interieri”. Ky departament përmbush detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, duke përfshirë numrin e titujve dhe gradave të stafit akademik. Në vitet e fundit, numri i stafit akademik ka pësuar një rritje të konsiderueshme, e cila ka kontribuar ndjeshëm në ruajtjen e një ngarkese të barabartë mësimore, pavarësisht rritjes së numrit të studentëve. Kjo rritje e stafit ka ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mbështetjen e nevojshme për studentet.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për	Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Dizajn” me profil “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interieri”, dhe ka në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturimin dhe përmbajtjen e programeve. Aneksi 1.1.1 Organigrama UNYT

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-13123

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>																																					
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor i programit Bachelor në Dizajn përmban një listë të lëndëve dhe moduleve të ndara në semestra, duke specifikuar kategorinë e veprimtarisë dhe ngarkesën mësimore për secilën: leksione, seminare, laboratorë, kohën në auditor dhe kohën jashtë auditorit. Çdo semestër studimi ka 30 kredite ECTS dhe në përfundim të tre viteve studentët marrin 180 ECTS.</p> <p>Programi i studimit parashikon 1995 orë në auditor, nga të cilat:</p> <table border="1" data-bbox="576 680 1461 1032"> <thead> <tr> <th colspan="2" style="text-align: center;">Dizajn Grafik</th> </tr> <tr> <th style="text-align: center;">Format e mësimdhënies</th> <th style="text-align: center;">Orët totale në auditor</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksione</td> <td style="text-align: center;">855</td> </tr> <tr> <td>Seminare</td> <td style="text-align: center;">465</td> </tr> <tr> <td>Ushtrime/Laboratore</td> <td style="text-align: center;">255</td> </tr> <tr> <td>Detyra/Projekte</td> <td style="text-align: center;">390</td> </tr> <tr> <td>Diploma/Provimi Final</td> <td style="text-align: center;">15</td> </tr> <tr> <td>Praktikë</td> <td style="text-align: center;">15</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td style="text-align: center;">1995</td> </tr> </tbody> </table> <table border="1" data-bbox="576 1066 1461 1417"> <thead> <tr> <th colspan="2" style="text-align: center;">Dizajn Interior</th> </tr> <tr> <th style="text-align: center;">Format e mësimdhënies</th> <th style="text-align: center;">Orët totale në auditor</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksione</td> <td style="text-align: center;">765</td> </tr> <tr> <td>Seminare</td> <td style="text-align: center;">555</td> </tr> <tr> <td>ushtrime/Laboratore</td> <td style="text-align: center;">255</td> </tr> <tr> <td>Detyra/Projekte</td> <td style="text-align: center;">390</td> </tr> <tr> <td>Diploma/Provimi Final</td> <td style="text-align: center;">15</td> </tr> <tr> <td>Praktike</td> <td style="text-align: center;">15</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td style="text-align: center;">1995</td> </tr> </tbody> </table> <p>Aneksi 1.3 Plani mesimor-kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn Aneksi 2.1 Tabelat përmbledhëse</p>	Dizajn Grafik		Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor	Leksione	855	Seminare	465	Ushtrime/Laboratore	255	Detyra/Projekte	390	Diploma/Provimi Final	15	Praktikë	15	Në total	1995	Dizajn Interior		Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor	Leksione	765	Seminare	555	ushtrime/Laboratore	255	Detyra/Projekte	390	Diploma/Provimi Final	15	Praktike	15	Në total	1995
Dizajn Grafik																																					
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor																																				
Leksione	855																																				
Seminare	465																																				
Ushtrime/Laboratore	255																																				
Detyra/Projekte	390																																				
Diploma/Provimi Final	15																																				
Praktikë	15																																				
Në total	1995																																				
Dizajn Interior																																					
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor																																				
Leksione	765																																				
Seminare	555																																				
ushtrime/Laboratore	255																																				
Detyra/Projekte	390																																				
Diploma/Provimi Final	15																																				
Praktike	15																																				
Në total	1995																																				
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacionet e nevojshme për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të paraqitura në 'Rregulloren e Programit te studimeve dhe Politika e transferimit të studimeve. Një informacion i përgjithshëm publikohet edhe në web site.</p> <p>Aneksi 1.10 Rregullore Programi, Neni 7, 8, 9 Aneksi 2.9 Politika e transferimit të studimeve</p>																																				



<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Rregulloret e programit të studimit në Dizajn (Aneksi 1.10) dhe plani mesimor (Aneksi 1.3) përfshijnë kurrikulën me të dhënat e ngarkesës mësimore për secilën lëndë. Këto detaje dhe specifikime gjithashtu janë të përshkruara në syllabuset e lëndëve (Aneksi 2.2).</p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit është duke u akredituar për herë të parë dhe nuk ka pësuar ndryshime në përmbajtjen e tij mësimore. Sipas diskutimeve me stafin akademik, syllabus-et përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo viti akademik. Ky proces ka për qëllim të sigurojë që informacioni i ofruar studentëve është i saktë, aktual dhe i përditësuar. Përditësimi i syllabus-ve është një hap thelbësor që jo vetëm siguron përmirësimin e vazhdueshëm të programit, por gjithashtu mundëson zbatimin e ndryshimeve të nevojshme për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e Dizajnit të Brendshëm dhe Dizajnit Grafik. Kjo qasje e vazhdueshme dhe dinamike garanton që programi të mbetet në përputhje me nevojat dhe kërkesat e industrisë, duke i përgatitur studentët më mirë për sfidat e tregut të punës.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Departamenti i “Arkitekturës dhe Dizajnit” paraqet një burim të pasur informacioni dhe dokumentacioni për programin e Studimit Bachelor në Dizajn, me profil “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interieri”, duke theksuar organizimin dhe strukturën e kurrikulës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4


Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë,</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Dizajn, në mënyrën se si është i strukturuar përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve, I formon studentët me njohuri në fushën e dizajnit grafik, ilustrimit artistik dhe dizajnit të interierit, por jo me eksperize specifike. Ky</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13123

Email: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>thellim të njohurive dhe aftësi për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>program fokus të veçantë në tema profesionale që kanë të bëjnë me dizajnin e identitetit të kompanive, publikimeve të reklamave, imazheve lëvizëse dhe video, dizejnimin e siteve web, ai dhe projektimin e interiereve të ndryshme nëpërmjet programeve kompjuterike të modelimi 3D, vizualizimit dhe renderizimit, njohuri të cilat janë shumë të kërkuara në tregun e punës.</p> <p>Aneksi 1.3 Plani mesimor-kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn</p> <p>Aneksi 2.2 Syllabuset</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Dizajn, me profil “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interieri”, u ofron studentëve mundësinë të marrin pjesë në një program që ndërthur teorinë dhe praktikën në fushën e artit, dizajnit, arkitekturës, si dhe aspekteve ekonomike dhe të marketingut. Kurrikula e programit synon të balancojë lëndët dhe kreditet gjatë gjithë semestrave akademikë, me qëllim që vlerësimi në kredite dhe orë mësimore të jetë i drejtë dhe në proporcion me peshën dhe rëndësinë e çdo lënde.</p> <p>Nga verifikimi i programit të studimit Bachelor në "Dizajn" dhe nga orari mësimor, është evidentuar një mangësi në orët e realizuara, bazuar në ngarkesën totale të orëve sipas kurrikulës.</p> <p>Aneksi 1.3 Plani mesimor-kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn</p> <p>Aneksi 2.1 Tabelat permbledhese _ Tabela 4 / Tabela 10</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit dhe lëndët e ofruara mund të përmirësohet në përputhje me sugjerimet në komentet e Kriterit 2. Sa i përket raportit teori-praktik, secila lëndë është në përputhje me nevojat e programit të studimit.</p> <p>Aneksi 1.3 Plani mesimor-kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn</p> <p>Aneksi 2.2 Syllabuset</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Organizimi i kurrikulës sipas veprimtarive formuese në % të parashikuara nga ligji, si dhe raporti i orëve teorike, seminareve dhe orëve praktike/laboratorit (Aneksi 2.1, Aneksi 1.3) janë të ngjashme me programet ndërkombëtare dhe sigurojnë një përgatitje të mirë teorike dhe praktike të studentit për tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në</p>	<p>Rishikimi i silabuseve dhe përditësimi i tyre me versionet më të fundit të teksteve akademike, që shërbejnë si literaturë bazë apo ndihmëse për lëndën, është një proces i vazhdueshëm i kryer periodikisht nga Departamenti. Ky proces ka për qëllim përshtatjen e silabuseve me</p>

<p>përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>kërkesat e tregut të punës dhe teknologjitë më të reja, si dhe përditësimin e literaturës (Aneksi 2.2 Syllabusët). <i>Nga lista e teksteve në bibliotekë (3.33.1 Lista e literaturës për Arkitekturë dhe Dizajn) dhe nga bisedat me studentët e programit të studimit, rezulton se shumica e librave janë më të përshtatshëm për degën e arkitekturës. Numri i titujve të librave duhet të pasurohet, dhe disa nga librat e detyrueshëm në syllabus, që aktualisht mungojnë në bibliotekë, mund të sigurohen nga departamenti.</i> (Aneksi 2.2 Syllabusët).</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Për të përmirësuar kurrikulën mësimore dhe shpërndarjen e lëndëve në Programin e Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Dizajn" me profile "Dizajn Grafik" dhe "Dizajn Interier", mund të ndërmerren disa hapa strategjikë:</p> <p>1. Ristrukturimi i Programit: Viti i Parë: Përqendrimi në njohuritë bazë dhe përgjithshme, duke përfshirë lëndët ndërdisiplinore me zgjedhje që ndihmojnë në ndërtimin e një baze të gjerë të dijeve. Kjo do të mundësojë që studentët të fitojnë një kuptim të plotë të fushave të ndryshme që mund të ndikojnë në dizajn. Viti i Dytë: Thellimi në lëndët specifike të dizajnit, duke siguruar një lidhje të ngushtë midis teorisë dhe praktikës. Lëndët bazë dhe karakterizuese të dizajnit duhet të kenë përparësi për të përgatitur studentët për vitin e tretë. Viti i Tretë: Përqendrimi i plotë në specializimin e zgjedhur, duke ofruar mundësi për projekte praktike, internship-e dhe lëndë të avancuara të dizajnit. Kjo do të ndihmojë studentët të thellojnë njohuritë e tyre dhe të aplikojnë atë që kanë mësuar në situata reale.</p> <p>2. Përmirësimi i Organizimit të Lëndëve: Vazhdimësia e Dijsve: Sigurimi që lëndët janë të organizuara në mënyrë që të ndërtojnë mbi njohuritë e mëparshme. Për shembull, lëndët e teorisë së dizajnit mund të jenë të ndjekura nga lëndët praktike që i aplikojnë këto koncepte. Periudhat e Ofertës: Lëndët duhet të ofrohen në periudha që lejojnë studentët të përvetësojnë dhe të thellojnë njohuritë e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Për shembull, lëndët bazë duhet të përfundojnë përpara se të fillojnë lëndët e avancuara.</p> <p>3. Përfshirja e Lëndëve Ndërdisiplinore: Lëndët me Zgjedhje: Vendosja e lëndëve ndërdisiplinore në vitin e parë mund të ndihmojë studentët të zhvillojnë aftësi të ndryshme që mund të kontribuojnë në suksesin e tyre në dizajn. Këto lëndë mund të përfshijnë kurse mbi komunikimin, menaxhimin e projekteve, psikologjinë e ngjyrave, dhe teknologjinë e informacionit.</p>



	<p>Koordinimi me Lëndët Kryesore: Lëndët ndërdisiplinore duhet të jenë të koordinuara me lëndët kryesore të dizajnit për të siguruar që studentët të marrin një arsim të integruar dhe koherent.</p> <p>4. Praktika dhe Projekte të Avancuara: Projekte Praktike: Inkurajimi i studentëve të marrin pjesë në projekte praktike që lidhen drejtpërdrejt me fushën e tyre të studimit. Këto projekte mund të jenë të organizuara në bashkëpunim me kompani dhe organizata reale. Internship-e: Sigurimi i mundësive për internship-e gjatë vitit të tretë për të ndihmuar studentët të fitojnë përvojë praktike dhe të përgatisin për tregun e punës.</p> <p>Aneksi 1.3 Plani mesimor-kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi ofron përmbajtje që siguron mundësi të mira për punësim të studentëve pas përfundimit të studimeve, duke garantuar një ekspertizë të lartë në tregun e punës. Përveç kësaj, ky program u jep studentëve mundësinë për të vazhduar studimet e tyre në nivelin e Masterit në fusha të veçanta të dizajnit, si: Dizajn i Brendshëm, Reklamë, Komunikim Vizual, Dizajn Multimedial, Dizajn Grafik dhe Media Digjitale, Dizajn Industrial dhe Produkti, Dizajnin e Paisjeve Digjitale dhe Interaktive, Dizajnin e Informacionit dhe Visualizimit të të Dhënave, etj.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi ofron një përgatitje të gjerë teorike dhe praktike në fushën e dizajnit grafik dhe interier. Organizimi i kurrikulës dhe raporti i orëve janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të tregut të punës, siguroar një bazë të fortë për studentët. Mundësitë për koordinimin e lëndëve ndërdisiplinore dhe përmirësimin e orëve të plota mesimore në auditor mund të rrisin nivelin e përgatitjes së studentëve për tregun e punës. Gjithashtu, lista e librave të nevojshëm për programin specifik të dizajnit mund të paraqesin sfida për studentët gjatë studimeve të tyre. <i>Për të përmirësuar këtë gjendje, është e rëndësishme të bëhet një përditësim i rregullt i silabuseve dhe të pasurohet biblioteka me resurse të reja që plotësojnë nevojat specifike të programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbytjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Dizajn me profile në Interior dhe Grafik ofron njohuri të tmira në metoda dhe parime shkencore të përgjithshme në fushën e dizajnit për të dy profilet e specializimit. Ky program siguron një bazë të fortë të njohurive për arkitektët e interiorit dhe dizajnerët grafikë gjatë studimeve 3-vjeçare. Studentët zhvillojnë kompetenca në disiplina teknike dhe specifike të sektorit të dizajnit, duke përfshirë grafikën, brandet, teorinë dizajnuese dhe artistike, si dhe projektimin. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me aktorët e bizneseve, institucionet arsimore, studiot e projektimit dhe organizatat e ndryshme siguron një lidhje të qëndrueshme me tregun e punës dhe zhvillimin e karrierës për studentët.</p> <p>Aneksi 2.9 Strategjia e Zhvillimit të Programit Aneksi 5.1 Lista e MoU</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>UNYT ka krijuar një mjedis ku marrëdhënia ndërmjet institucionit, stafit akademik dhe studentëve është e thelbësore. Përfshirja e studentëve në procese vendimmarrëse si Senati dhe Këshilli i Etikës, si dhe pjesëmarrja e tyre në vlerësimin e mësimdhënies, tregon përkushtimin e institucionit për të dëgjuar dhe për të integruar mendimet e tyre. Qeveria Studentore dhe lidhjet e vazhdueshme me të diplomuarit, të koordinuara nga Zyrja e Karrierës dhe Alumni, sigurojnë një rrjet të fortë të kontakteve dhe mundësi për studentët për të përfituar nga përvoja dhe këshillat e të diplomuarve në tregun e punës. Kjo pjesëmarrje e të diplomuarve në leksione të hapura dhe panairë të karrierës ndihmon në përmirësimin e programeve të studimit duke reflektuar nevojat e tregut dhe sfidat aktuale të fushës së dizajnit.</p> <p>(Evidence: Takimi me studentet në Institucion, Aneksi 2.7 Përfshirja e studentëve në GVB Aneksi 2.7.1 Përfshirja e studentëve në Senat, NjSBC, Këshilli i Etikës, Aneksi 5.17 Paneli Alumni, Aneksi 5.17.1 Komunikime Alumni)</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti ka bashkëpunimeve me kompani dhe organizata të sektorit, të cilat ndihmojnë në përmirësimet dhe përditësimet e programit të studimit. Aneksi 5.1 Lista e MoU, Aneksi 5.15.2 Lista e Kompanive pjesëmarrëse në Panair Gjithashtu Departamenti ka organizuar konferenca dhe seminare të përbashkëta, si dhe ka marrë pjesë në diskutime mbi përmirësimin e kurrikulave, që siguron një qasje të përgjegjshme dhe të përshtatshme ndaj zhvillimeve të fundit në fushën e arkitekturës dhe dizajnit.</p> <p>Aneksi 1.12 Evente, Leksione të hapura, Seminare 2021-24</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Dizajn në Universitetin e New Yorkut të Tiranës ka arritur një zhvillim të kujdesshëm dhe të përpiktë, duke u përshtatur me kërkesat dhe standardet e tregut të punës. Përmes konsultimeve aktive me institucione partnerë,</p>


	<p>diplomuar dhe aktorë të tregut të punës, programi ka siguruar një përmbajtje të pasur të teorisë dhe praktikës në dizajn grafik dhe interior, duke përfshirë metodat e fundit shkencore dhe artistike. Organizimi i kurrikulës dhe raporti i orëve janë hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke iu ofruar studentëve një bazë të fortë për zhvillimin e tyre profesional. Përveç kësaj, përfshirja e studentëve në procese vendimmarrëse dhe vlerësimin e mësimdhënies, bashkëpunimi i vazhdueshëm me Qeverinë Studentore dhe Alumni, si dhe pjesëmarrja e aktorëve të tregut të punës në aktivitete të programit, ka kontribuar në rritjen e cilësisë së programit dhe përshtatjen e tij me nevojat dhe sfidat aktuale të fushës së dizajnit. Departamenti i Dizajnit ka pasur sukses në përshtatjen e programit të studimit në bashkëpunim me rrjetet profesionale dhe institucionet e tregut, duke siguruar një qasje të përgjegjshme ndaj zhvillimeve të fundit në arkitekturë dhe dizajn.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Përveç metodave të parashikuara për mësimdhënie në Programin e Studimit Bachelor në "Dizajn", si leksione, seminare, detyra, projekte, praktikat, praktikat profesionale dhe përgatitjen për temën e diplomës, Departamenti i "Arkitekturës dhe Dizajnit" ka organizuar edhe disa aktivitete me karakter didaktik, si leksione të hapura, vizita në ekspozita, galeri arti, institucione kulturore dhe artistike, atelier, kantieri ndërtimi, pjesëmarrja e studentëve në konkurse etj. Aneksi 1.11 Activities- Study -Field trips 2021-24, Aneksi 1.12 Evente, Leksione të hapura, Seminare 2021-24
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma,	Stafi i Departamentit të Artit të Dizajnit u përgjigjet nevojave të studentëve duke ofruar jo vetëm leksione, por edhe aktivitete alternative akademike si leksione të hapura, vizita në studio apo kompani, workshope, ekspozita studentore, etj.

<p>mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Aneksi 1.11 Activities- Study -Field trips 2021-24 Aneksi 1.12 Evente, Leksione të hapura, Seminare 2021-24 Aneksi 1.13 Workshop 2021-24 Aneksi 1.14 Ekspozita studentore</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nëpërmjet njoftimeve të ndryshme, UNYT e informon stafin akademik të marrin pjesë në programe mobiliteti (Erasmus+, Mevlana, etj.) në institucionet partnere të huaja për të shkëmbyer përvoja në mësimdhënie dhe kërkime shkencore. Po ashtu, zyrat e ndryshme të UNYT informojnë rregullisht stafin për mundësitë e pjesëmarrjes në trajnime, seminare dhe konferenca të organizuara jashtë institucionit. Stafit akademik i vihet në dispozicion një manual pedagogjik ("Instructor's Handbook"), që është një burim i pasur informacioni dhe ndihme për çështje të ndryshme të organizimit të mësimdhënies.</p> <p>Aneksi 1.31 Statistika Shkembim Stafi Aneksi 3.7.1 Mbeshtetje financiare per kerkim shkencor Aneksi 3.6 Manuali i Instrukturëve</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga vlerësimi i studentëve, në pyetësoret mbi procesin mësimor të realizuar 2 herë në vit, rezulton se stafi akademik është në nivelin e pritshmërive të tyre, si në aspektin e përgatitjes mësimore edhe në mënyrën e komunikimit (Aneksi 6.9.1, 6.9.2, 6.9.3, 6.9.4, 6.9.5, 6.9.6 Vlerësimet e Pedagogëve Vjeshtë 2023-2024). Kjo ishte e qartë edhe nga biseda me studentet, gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Institucioni inkurajon ndërveprimin e pedagogut dhe studentit edhe jashtë orarit të lëndëve gjë që i vjen në ndihmë studentit, sidomos për punimin e projekteve të zhvilluara në mënyrë të pavarur, ku ata mund të komunikojnë dhe të shkëmbejnë materiale me pedagogun.</p> <p>Aneksi 3.3 Detyrat e pedagogëve udhëheqës</p> <p><i>Nga biseda me studentet gjatë vizitës në Institucion, rezulton se pedagogët janë mjaft të disponueshëm edhe përtej orarit mësimor dhe ka një marrëdhënie respekti të ndërsjellë mes tyre.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin e studimit përfshin studentët në vlerësimin e mësimdhënjes përmes pyetësoreve periodike 2 herë në vit, ku ata vlerësojnë mënyrën e mësimdhënjes, metodat e mësimdhënjes <i>Formulari i përdorur për vlerësimin e mësimdhënies plotësohet dy herë në vit, por duhet të ketë një pjesëmarrje më të madhe të studentëve. Duhet të ndihmojnë në marrjen e masave përmirësuese në mësimdhënie dhe kërkimin akademik, në të mirë të studentëve dhe stafit etj.</i></p> <p>(Aneksi 6.9 Formular Vlerësimi nga Studentet).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të</p>	<p>NJSBC, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin janë struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e mësimdhënjes (Aneksi 6.17 Trajnim NJSBC, Aneksi 6.16.1 Plan Vjetor NJSBC 2023-2024).</p>



<p>mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Evidencat tregojnë se aktivitetet didaktike, si punëtoritë, leksionet e hapura dhe konferencat studentore, kanë kontribuar ndjeshëm në jetën akademike aktive, duke pasuruar përvojat e studentëve në lidhje me tregun e punës dhe profesionin e tyre.</i></p> <p><i>Ekzistojnë trajnime për stafin, brenda dhe jashtë institucionit, si dhe shkëmbime me kolegë nga vendi dhe jashtë vendit, të cilat pasurojnë përvojën e stafit akademik me metoda dhe kompetenca të avancuara të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Formulari i përdorur për vlerësimin e mësimdhënies plotësohet dy herë në vit, por duhet të ketë një pjesëmarrje më të madhe të studentëve. Duhet të ndihmojnë në marrjen e masave përmirësuese në mësimdhënie dhe kërkimin akademik, në të mirë të studentëve dhe stafit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Dizajn, është përcaktuar mënyra e vlerësimit të njohurive të studentëve përmes një sistemi kontrolli të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të komponentëve të mëposhtëm: Pjesëmarrja dhe aktivizimi 10%, Provimi i Ndermjetëm 30%, detyrë/a kursi 20% dhe Provimi Final 40% (Aneksi 1.10 Rregullore e Programit).</p> <p>Cdo lëndë jep specifikime të hollësishme në syllabus lidhur me organizimin e provimeve dhe kriteret e vlerësimit (Aneksi 2.2</p>

	<p>Syllabuses), i cili i bëhet i ditur studentit ditën e parë të fillimit të kursit.</p> <p>Kjo u evidentua edhe nga procesverbalet e notave në Sekretarinë mësimore si dhe nga biseda me studentët gjatë vizitës në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studenti njihet me mënyrën e vlerësimit të dijes përmes syllabusit që i jepet dhe shpjegohen orët e para të mësimi. Gjithashtu, studenti njihet përmes syllabusit edhe me format e testimi, provimi dhe dorëzimit të projektit në varësi të lëndës, si dhe me kriteret e vlerësimit (Aneksi 2.2 Syllabuset).</p> <p><i>Studentet konfirmojne se jane ne dijeni te menyrave te vleresimit permes syllabusit. (Nga biseda me studentet ne institucion)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme, ku vlerësohet jo vetëm rezultati në provimet perfundimtare apo ne dorëzime detyrash/projekte, nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, dhe pjesëmarrja aktive në klasë në diskutime apo punë praktike. Studentet dhe pedagoget konfirmojne keto menyra testimi. Po ashtu ne institucion ka evidencca te projekteve te studenteve.</p> <p>Aneksi 1.9 Regullore e Departamentit Aneksi 1.10 Regullore e Programit Aneksi 2.2 Syllabuset</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Rezultatet e provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare raportohen zakonisht brenda një jave që nga momenti i realizimit.</p> <p>Sistemi elektronik Kion u jep studentëve mundësinë të kontrollojnë notën e tyre.</p> <p>Aneksi 2.16 Sistemi KION</p> <p>Provimet e korrigjuara dhe vlerësimet e projekteve shoqërohen në komente me gojë. Studentët kanë të drejtë të kërkojnë t'i shohin provimet e korrigjuara.</p> <p>Aneksi 3.13 Protokoli i Provimit</p> <p>Kjo konfirmohet nga stafi, studentet, dhe sekretaria mesimore (gjate vizites ne institucion).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> <p>Kriteri 6Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë</p>	<p>Institucioni u ofron stafit dhe studentëve postë elektronike për të mundësuar një komunikim të drejtpërdrejtë edhe jashtë orarit të mësimave. Nga biseda me studentët gjate vizitës në Institucion rezulton se kjo është një nga mënyrat e komunikimit me stafin akademik. Kjo nxit punën e pavarur të studentit, si dhe i jep mundësinë të komunikojë me pedagoget në rast të paqartësive dhe pyetjeve të tyre. Pedagogëti plotësojnë leksionet tradicionale me metoda të tjera si orë praktike në laborator, demonstrime, makete, diskutime në klasë, detyra dhe projekte sfiduese individuale dhe në grupe, prezantime.</p>



sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Aneksi 1.11 Aktivitete - Study - Field trips 2021-24 Aneksi 1.12 Evente, Leksione të hapura, Seminare 2021-24 Aneksi 1.13 Workshop 2021-24 aleri apo studio etj.			
Konkluzione	<i>Sistemi i vleresimit eshte qartesisht shprehur ne syllabusin e lendes. Studentet konfirmojne se jane ne dijeni te menyrove te vleresimit permes syllabusit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet përmes një sistemi të vazhdueshëm të kontrollit gjatë semestrit, ku nota e përfundimtare rezulton nga kombinimi i komponentëve të mëposhtëm: Pjesëmarrja dhe angazhimi 10%, Provimi i ndërmjetëm 30%, aktivitete të tjera 20%, dhe provimi final 40%. Kjo dokumentohet edhe në sekretarinë mësimore dhe u pohua edhe nga vetë studentët gjatë vizitës në institucion. Aneksi 1.10 Rregullore e Programit, Neni 32 Aneksi 2.2 Syllabuset
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Kontrolli i njohurive mund të bëhet nëpërmjet provimeve me gojë, provimeve me shkrim ose dorëzimit të projekteve të kursit. Institucioni ve në dispozicion të pedagogëve sisteme elektronike anti-plagjaturë si Turnitin, për kontrollin e detyrave dhe temave të diplomës. Në këtë mënyrë, Turnitin e lehtëson pedagogun në identifikimin e rasteve të kopjimit të detyrave dhe plagjaturës prej studentëve. Në një kohë të rritjes së përdorimit të Inteligjencës Artificiale për gjenerimin e përmbajtjes, Turnitin ka shtuar së fundi edhe aftësinë për të identifikuar përmbajtje të gjeneruar nga IA me një konfidencë prej 98% ^[1] . Aneksi 3.14 Shembull i projekteve të studentëve në dorëzimin final Po ashtu pedagogët përdorin metoda dixhitale për të evituar plagjaturën e projekteve grafike si psh: për identifikimin e imazheve të përdorura më parë në internet, me qëllim të mbajtjes së origjinalitetit dhe parandalimit të plagjiaturave. Në lëndët e dizajnit, pedagogët vlerësojnë projektet grafike të studentëve duke përdorur platformën <i>Google Images</i> . Ky instrument shërben për identifikimin e imazheve të

	përdorura më parë në internet, me qëllim të mbajtjes së originalitetit dhe parandalimit të plagjiaturave.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me sylabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Mënyra e vlerësimit dhe pesha specifike e secilit komponent u bëhen të qarta studentëve nëpërmjet sylabusit të lëndës. Kjo mënyrë vlerësimi konfirmohet nga studentet dhe procesverbali në sekretarinë mesimore si edhe nëpërmjet sylabusit të lëndës. Aneksi 3.10 Raporti i transparencës së notave 2022-23
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studentet marrin notën e tyre Sistemi elektronik Kion. Në bazë të Kalendarit Akademik, rezultatet e provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare raportohen zakonisht brenda një jave që nga momenti i realizimit. Studentët kanë të drejtë të kërkojnë t'i shohin provimet e korigjuara. Për këtë arsye, në fund të çdo provimi pedagogu organizon seanca konsultimi ku komunikohet rezultati dhe jepet një feedback i përgjithshëm. Aneksi 3.13 Protokoll i Provimit
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në bazë të rregullores së Programit të Studimit, personeli akademik siguron zhvillimin korrekt të provimeve duke iu referuar rregullores në lidhje me materialet e ndaluara dhe pasojat e mundshme në rast të shkeljes së saj. Për parandalimin e kopjimit në provime, rregullat e protokollit të provimeve të UNYT trajtojnë çështje të tilla si pajisjet elektronike, kopjimi dhe mënyra e shkrimit të provimit. Aneksi 3.13 Protokoll i Provimit
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultati i provimit i jepet studentit brenda javës nga data e zhvillimit të provimit. Studentët njihen me rezultatin në mënyrë elektronike përmes sistemit online të quajtur Pitagora. Studentet, konfirmojnë përdorimin e programit Pitagora për marrjen e rezultateve të provimeve në mënyrë elektronike. Për vlerësimet e vendosura nga pedagogu, studentët informohen në kohë nëpërmjet postës elektronike, sistemeve LMS (Google Sites/Classroom, Microsoft Teams) si dhe në seancat sqaruese për kontrollin e notës. (Nga biseda gjatë vizitës në institucion dhe Aneksi 3.18 Komunikimi i notave të provimit)
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut,	Në bazë të Rregullores së programit të studimit (Aneksi 1.10 Rregullorja e Programit), studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit ose të ankimohet për vlerësimin duke u konsultuar fillimisht me vetë pedagogun e lëndës. Në rast se sërish kanë dyshime dhe mendojnë se meritojnë vlerësim të ndryshëm apo më të lartë, studentët mund të bëjnë një ankesë me shkrim brenda 48 orëve nga momenti kur notat shpallen nga sekretaria në faqen online. Ankimi duhet të

<p>rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>depozitohet te Zyra e Çështjeve Studentore (“Students Affairs Office”) ose që plotësohet direkt online nëpërmjet Peticionit Akademik (https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Ky program ka një ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik, imazhin e bizneseve dhe markave, duke plotësuar nje nevojë te tregut dhe duke shtuar vlerë në tregun vendas dhe ndërkombëtar. Sistemi i vlerësimit është transparent dhe dokumentohet qartë në rregullore, duke përfshirë pjesëmarrjen, provimin ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar. Studentët kanë mundësi të marrin rezultatet e provimeve përmes një platforme online KION, duke sjellë transparencë dhe lehtësi në shpalljen e notave. Universitetit ka sistem elektronik anti-plagjiaturë, Turnitin për kontrollin e detyrave dhe temave të diplomës. Po ashtu pedagogët përdorin metoda dixhitale për të evituar plagjaturën e projekteve grafike si psh: për identifikimin e imazheve të përdorura më parë në internet, me qëllim të mbajtjes së origjinalitetit dhe parandalimit të plagjiaturave. Në lëndët e dizajnit, pedagogët vlerësojnë projektet grafike të studentëve duke përdorur platformën <i>Google Images</i>. Ky instrument shërben për identifikimin e imazheve të përdorura më parë në internet, me qëllim të mbajtjes së origjinalitetit dhe parandalimit të plagjiaturave.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit, në përputhje me rregulloren e tij (Aneksi 1.10 Rregullorja e programit) dhe strukturën e kurrikulës, siguron një thellim graduale të njohurive. Fillon nga lëndë bazë të përgjithshme dhe vizatime kryesisht me dorë në vitin e parë, vazhdon me lëndë profesionale në vitin e dytë dhe përfundon me lëndë të specializuara që thellojnë njohuritë profesionale në vitin e tretë.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive</p>	<p>Programi i studimit garanton kompetenca dhe zhvillimin e aftësive në fushën e dizajnit analog dhe digjital, komunikimit vizual, si dhe</p>

<p>të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>shkencave humane. Universiteti mund të ofroj nje game me te gjere te lendeve me zgjedhje në nivel departmenti, fakulteti apo në nivel universiteti.</p> <p>Aneksi 1.3 Plani mesimor-kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Rezultatet e të nxënëve paraqiten në fillim të çdo syllabusi (Aneksi 2.2 Syllabuset). Në përfundim të lëndës, pedagogët bëjnë një raport semestral ku tregohet realizimi i objektivave të mësimi. Drejtuesi i Departamentit kontrollon në mënyrë rastësore disa nga lëndët dhe përpilon Raportin e Transparencës së Notave, Raportin Vjetor të Monitorimit, etj. (Aneksi 1.15 Raporti Vjetor i Monitorimit DAD 2021-22).</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Dizajn ndërthur orët teorike me punë praktike në laborator dhe praktikën profesionale. Personeli akademik mbështet punën në grup. Disa nga detyrat e kursit parashikohen të punohen në grup në mënyrë që të nxitet diskutimi, komunikim, konfrontimi i ideve dhe zgjidhja e problematikave të projektit nëpërmjet brainstorming për të gjeneruar ide inovative dhe projekte të avancuara. Gjithashtu, insitucioni nxit studentët të marrin pjesë në konkurse, për të propozuar zgjidhje kreative dhe inovative. Shpeshherë studentët e disiplinave të ndryshme, si Arkitekturë, Dizajn Interieri dhe Dizajn Grafik, bashkëpunojnë në grupe të ndryshme në konkurse në fushat e tyre, siç është rasti i konkursit për dizajnimin e laboratorëve kompjuterikë të shpallur nga Ministria e Arsimit.</p> <p>Aneksi 3.24 Pjesëmarrja e studentëve në konkurse Aneksi 3.24.1 Pjesëmarrje në konkurse dhe cmime të fituara</p> <p>Institucioni, gjithashtu mbështet mobilitetin dhe shkëmbimin e eksperiencave me insitucione partnere. Këto bashkëpunime kanë mundësuar edhe shkëmbime në kuadër të programeve Erasmus + dhe leksione të hapura me të ftuar nga këto insitucione. Një rol të rëndësishëm luan lënda e Praktikës (internship), e cila ndiqet pranë kompanive të sektorit të ndertimit, apo studiove të arkitekturës së interierit dhe agjencive të reklamave apo dizajnit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Departamenti i “Arkitekturës dhe Dizajnit” organizon leksione të hapura me specialistë të fushave të dizajnit dhe artit, jashtë orarit të programit të studimit. Kjo mundëson afrimin e studentëve me profesionin e lirë dhe njohjen me problematikat dhe sfidat e tregut të punës. Stafi i departamentit ofron një sërë leksionesh online falas për maturantët e shkollave të mesme, nga pedagogë të departamentit me</p>



<p>brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>tematika si vizatimi në arkitekturë dhe interior, modelimi, historia e dizajnit grafik dhe metodat e kompozimit, si dhe kanë marrë pjesë në panele seminaresh me gjimnazistë.</p> <p>Aneksi 3.25 Leksione falas për maturantët Aneksi 3.21 Aktivitete 2020-2021 Aneksi 3.22 Aktivitete 2021- 2022 Aneksi 3.23 Aktivitete 2023-2024 Aneksi 3.38 Evente në UNYT Aneksi 3.39 Aktivitete në UNYT</p> <p>Një pjesë e personelit janë aktivizuar në programe të mobilitetit, si Erasmus+, për të realizuar orë të hapura në universitete partnere ndërkombëtare</p> <p>Aneksi 1.31 Statistika Shkëmbim Stafi Aneksi 2.19 Shkëmbim Stafi D. Kavaja Aneksi 2.20 Shkëmbim Stafi D. Papa Aneksi 2.21 Shkëmbim Stafi M. Prifti_SVAKO Aneksi 2.22 Shkëmbim Stafi E. Gemi_ASBU</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi kombinon në mënyrë të balancuar orët teorike me punën praktike në laborator dhe praktikën profesionale, duke i pajisur studentët me njohuri dhe përvoja të rëndësishme për t'u njohur me tregun e punës dhe sfidat e tij aktuale. Aktivitetet si leksionet e hapura dhe puna në grup synojnë të forcojnë aftësinë e studentëve për të kuptuar thellë profesionin e tyre dhe për të zbuluar sfidat e tregut të punës. Gjithashtu, programi inkurajon bashkëpunimet dhe shkëmbimet me institucione partnere, ku personeli ka implementuar programe të mobilitetit si Erasmus+, duke ofruar mundësi për orë të hapura në universitete partnere ndërkombëtare.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën</p>	<p>Për provimin përfundimtar dhe punimin e diplomës, rregullat janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Brenda një muaji nga fillimi i vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit informon studentët që pritet të diplomohen atë vit lidhur me temat e diplomave. Tema e diplomës zgjidhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin dhe miratohet nga Departamenti. Para regjistrimit në Projektin e Diplomimit, studenti duhet të ketë përfunduar praktikën</p>

<p>studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>profesionale. Gjithashtu, studenti duhet të ketë përfunduar së paku 144 ECTS dhe të mos ketë lëndë të mbetura nga viti i parë akademik.</p> <p>Aneksi 1.7 Rregullorja e UNYT, Neni 28 dhe 29 Aneksi 1.10 Rregullorja e Programit Bachelor në Dizajn Neni 29 dhe 30 Aneksi 2.11 Rregullore e Projektit të Diplomimit</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në rregulloren e punimit të diplomës, janë të përshkruara udhëzime të detajuara për studentët, të cilat përfshijnë aplikimin për temën e diplomës, zgjedhjen dhe miratimin e udhëheqësit, si dhe tri kontrole të detyrueshme. Rregullorja gjithashtu përshkruan dorëzimin e punimit dhe procedurat e mbrojtjes. Për secilin nga këto hapa, rregullorja përcakton kërkesat specifike që studenti duhet të plotësojë. Lidhur me detyrimet përfundimtare, pedagogët udhëheqës, të caktuar sipas rregullores dhe manualit përkatës, ofrojnë mbështetje për studentët në çdo fazë të realizimit të tezës së diplomës. Po ashtu, dokumenti "Detyrat e pedagogëve udhëheqës gjatë semestrit akademik" përcakton mënyrat se si studentët orientohen dhe asistohen nga këshilluesi akademik ("Academic Advisor").</p> <p>Aneksi 3.3 Detyrat e pedagogëve udhëheqës Aneksi 2.11 Rregullore e Projektit të Diplomimit Aneksi 2.12 Manuali i projektit të diplomes</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisioni i posaçëm për organizimin e provimit final të diplomës nuk teston njohuritë e marra gjatë gjithë viteve akademike, por vlerëson punimin e diplomës të realizuar nga studenti sipas rregullores së Punimit të Diplomës. Në Rregulloren e Programit (Neni 29), përcaktohet që diplomimi realizohet me anë të projektit (tezës) të diplomimit dhe nuk aplikohet provim i përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Aneksi 1.10 Rregullore e Programit Aneksi 2.11 Rregullore e Projektit të Diplomimit Aneksi 2.12 Manuali i projektit të diplomes</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse</p>	<p>Udhëheqësi i punimit të diplomes udhëzon dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temës së punimit (Aneksi 2.11 Rregullore e Projektit të Diplomimit). Udhëheqësi i vë në dispozicion studentit të gjithë bazën materiale të nevojshme si Udhëzues/Manual, Template të Tezës, Udhëzime për Citimet, Listën e Kritereve që duhet të plotësojë studentin në tezën e tij, etj.; si dhe kontrollon vazhdimisht progresin e punës së studentit, duke i dhënë komente dhe këshilla.</p>



punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.				
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Departamenti i "Arkitekturës dhe Dizajnit" ofron laboratorët, stafin dhe ambientet e institucioneve partnere për të mundësuar realizimin e temave të diplomës me sukses.			
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi përfundimtar i programit Bachelor në Dizajn përfshin një punim diplomë që vlerësohet me notë. Aneksi 2.11 Rregullore e Projektit të Diplomimit Aneksi 2.12 Manuali i projektit të diplomes			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS, në programin e studimit Bachelor në Dizajn me profil "Dizajn Grafik" dhe "Dizajn interieri" do të pajiset me diplomën dy-gjuhëshe me emërtimin 'Bachelor' në 'Dizajn me profil Dizajn Grafik' ose Bachelor në "Dizajn me profil Dizajn Interier". Studenti do të marrë Diplomën, Vërtetimin e Notave zyrtare dhe një Suplement Diplome. Aneksi 3.31 Formatit i Diplomës Aneksi 3.32 Suplement Diploma Dizajn me profil Dizajn Grafik Aneksi 3.32.1 Suplement Diploma Dizajn me profil Dizajn Interier Studentëve të interesuar, me kërkesën e tyre, u ofrohet një kopje të plotë të programit të studimit si dhe syllabus-eve të lëndëve.			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Të dhënat e studentit të diplomuar ruhen në sekretarinë mësimore dhe në regjistrat themeltar. <i>Kjo u verifikua me përzgjedhje rastësore të disa studenteve gjatë vizitës në Institucion. Kështu, studenti mund të marrë informacion mbi të dhënat e tij në çdo kohë.</i>			
Konkluzione	Në rregulloren e punimit të diplomës, janë përcaktuar udhëzime të qarta për studentët që përfshijnë aplikimin për temën e diplomës, zgjedhjen dhe miratimin e udhëheqësit, kryerjen e tre kontrolleve të detyrueshme, dorëzimin dhe procedurën e mbrojtjes. Çdo fazë e këtij procesi ka kërkesa të detajuara që studentët duhet të plotësojnë. Për detyrimet përmbyllëse, udhëheqësit e diplomës, të caktuar sipas rregullore dhe manualit, ofrojnë mbështetje në çdo hap të përgatitjes së tezës së diplomës. Për më tepër, "Detyrat e pedagogëve udhëheqës gjatë semestrit akademik" përcakton mënyrën sesi studentët orientohen dhe asistohen nga këshilluesi akademik ("Academic Advisor").			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Në programin e Studimit Bachelor në Dizajn personeli akademik dhe ndihmës që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për:</p> <ul style="list-style-type: none"> Niveli i kualifikimit akademik: 'Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. <p>Aneksi 2.1 Tabelat permbledhese Tab. 4</p> <p>Përveç kësaj, personeli akademik dhe ndihmësi plotësojnë kërkesat ligjore për:</p> <ul style="list-style-type: none"> Drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit. Fushën kërkimore ose përvojën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, duke arritur mbi 70% të ngarkesës mësimore në vit. Titullarët e lëndëve/modules për programet e studimeve të ciklit të parë janë profesore, profesore të asociuar dhe doktorë të shkencave (PhD). Ata asistohen, sipas rastit, nga asistent lektorë me gradë PhD Candidate ose MSc, të cilët janë angazhuar përmes kontratash specifike. Angazhimi akademik, administrativ, kërkimor dhe aktivitetet e tjera të lidhura me mësimdhënien shpërndahen sipas anekseve specifike të këtyre kontratave.</p> <p>Aneksi 1.3 Plani mesimor-kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn Aneksi 2.1 Tabelat permbledhese Tab. 4</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>UNYT përdor dy formate kryesore të kontratave për stafin: një kontratë për staf me kohë të plotë dhe një tjetër për staf me kohë të pjesshme. Për stafin me titull MSc, ofrohet një kontratë njëvjeçare me afat të përcaktuar. Sigurimi i mbulimit për sigurime shoqërore dhe shëndetësore bëhet në përputhje me afatet e sistemit tatimor në Shqipëri.</p> <p>Sipas Tabelave përmbledhëse (Aneksi 2.1 Tabelat përmbledhëse Tab. 2), personeli akademik tregon qëndrueshmëri në pozitat e mësimdhënies në departament. Universiteti gjithashtu investon në angazhimin e stafit me kohë të pjesshme, duke mundur rishkrimin e kontratës dhe rikthimin e tyre vit pas viti. Kjo marrëdhënie rregullohet përmes përditësimit të kontratave nga të dyja palët. Stafi akademik për tre vitet ka këto perberje.</p> <table border="1" data-bbox="619 689 1441 1131"> <thead> <tr> <th rowspan="3">Titulli</th> <th colspan="6">Stafi akademik për programin e studimit</th> </tr> <tr> <th colspan="2">(2021 - 2022)</th> <th colspan="2">(2022 - 2023)</th> <th colspan="2">(V2023 - 2024)</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td></td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td></td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>4</td> <td>0</td> <td>10</td> <td>1</td> <td>13</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc (ne proces Dr)</td> <td></td> <td>0</td> <td></td> <td>0</td> <td></td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td></td> <td>7</td> <td>1</td> <td>10</td> <td>5</td> <td>18</td> <td>8</td> </tr> </tbody> </table>	Titulli	Stafi akademik për programin e studimit						(2021 - 2022)		(2022 - 2023)		(V2023 - 2024)		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	0	0	0	0		0	Prof. Asoc.	0	0	0	0		0	Dr/Phd	4	0	10	1	13	2	Msc (ne proces Dr)		0		0		0	Msc	3	1	2	4	5	6		7	1	10	5	18	8
Titulli	Stafi akademik për programin e studimit																																																													
	(2021 - 2022)		(2022 - 2023)		(V2023 - 2024)																																																									
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																								
Prof. Dr	0	0	0	0		0																																																								
Prof. Asoc.	0	0	0	0		0																																																								
Dr/Phd	4	0	10	1	13	2																																																								
Msc (ne proces Dr)		0		0		0																																																								
Msc	3	1	2	4	5	6																																																								
	7	1	10	5	18	8																																																								
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>(UNYT) ndjek një Procedurë të posaçme të Rekrutimit për të siguruar që procesi i rekrutimit të stafit akademik të përmbushë standardet e vendosura nga institucioni. Thirrjet për aplikime duhet të jenë të detajuara dhe të përfshijnë informacion të plotë mbi profilin e lëndëve dhe fushën e kërkimit.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të anëtarëve të stafit akademik, qoftë ata që janë angazhuar me kohë të plotë apo të pjesshme.</p> <p>Procedura e rekrutimit fillon me shpalljen e një vendi vakant nga Dekani i Fakultetit ose nga Përgjegjësi i Departamentit. Ky individ është i ngarkuar me sigurinë që kërkesat ligjore dhe standardet akademike të përmbushen, duke përfshirë nivelin e kualifikimit akademik, drejtimin e programit dhe mbulimin e lëndëve të programit.</p> <p>Aneksi 4.25 Format i shpalljes së pozicionit Aneksi 4.25.1 Format i standardit të procedurës së rekrutimit Aneksi 1.1 Statuti</p>																																																													
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të</p>	<p>Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit mbështetet për mbikëqyrjen e punëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike, nga zyra e Teknologjisë së Informacionit (TI) përbëhet nga dy specialistë që monitorojnë çdo problematikë në sallat kompjuterike dhe ofrojnë</p>																																																													



<p>përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>mbështetje për studentët, stafin administrativ dhe atë akademik. Staf i akademik dhe administrativ i programit është gjithashtu i angazhuar në zbatimin e programit; për shembull, orari i klasave përcaktohet nga drejtuesi i departamentit në bashkëpunim me Kryeregjistruesin dhe personelin akademik. Këto aktivitete janë të dokumentuara sipas vizitës në terren dhe Aneksit 4.17 - Shërbimet e TI-së.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni mbledh, ruaj dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe të personelit ndihmës dhe administrativ. Zyra e burimeve njerëzore disponon dosjen e çdo personelit ndihmës dhe administrativ. Kjo u verifikua gjatë kontrollit random në këtë zyre, gjatë vizitës në institucion. Zyra e Burimeve Njerëzore ka iniciuar unifikimin e resumeve të stafit akademik sipas APA style.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti cakton udhëheqësit për punimet e diplomës për studentët e programit bachelor dhe monitoron progresin e tyre deri në mbrojtjen me sukses të punimit të diplomës dhe diplomimin. Praktika profesionale është e integruar në një lëndë specifike të Internshipit në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve. Kjo praktikë kryhet në ambientet e institucionit, i cili raporton pjesëmarrjen dhe punën praktike Aneksi 2.11 Rregullore e Projektit të Diplomimit Aneksi 1.25 UNYT DAD Raporti i Internship Aneksi 1.27 Lista e Studentëve për Internship Aneksi 5.10 Lista e MoU</p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të</p>	<p>Praktika profesionale është e integruar në një lëndë specifike të Internshipit në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve. Kjo praktikë kryhet në ambientet e institucionit, i cili raporton pjesëmarrjen dhe punën praktike</p>



marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Aneksi 1.26 Raporti i Internship M. Dusha Aneksi 1.26.1 Feedback nga punedhenesi mbi praktiken e studentit			
Konkluzione	Institucioni përmbush kërkesat ligjore për numrin e pedagogëve me titullin Dr. dhe ka dokumentacion te rregullt mbi personelin e angazhuar në programin e studimit. Gjithashtu, institucioni ve ne dispozicion staf ndihmës që mbikëqyr punët laboratorike dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike tregon përkushtim ndaj sigurimit të resurseve të nevojshme për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni siguron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Një sistem qendror ngrohjeje dhe ftohjeje, uji dhe burimet alternative të energjisë krijojnë kushte të rehatshme për mësimdhënie, mësimnxënie dhe hulumtime në kampus. Ambientet e disponueshme janë të përshtatshme për te lejuar studentët dhe stafin e UNYT-së të kryejnë aktivitetet e tyre, të studiojnë si dhe të socializohen. Aneksi 4.12 Siperfaqja ne funksion te mesimdhënies East
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Të gjitha sallat janë të pajisura me: tavolina, karrige, tabela, dhe kompjuter dhe videoprojektor duke garantuar që mesimdhënja të zhvillohet në kushte të favorshme. Gjithashtu, e gjithë godina është e mbuluar nga një rrjet interneti wireless, i cili është i disponueshëm për të gjithë. (nga vizita ne institucion)

<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera janë në përputhje me natyrën e programit të studimit në Dizajn. Me ekzaktesisht ambientet që universiteti ofron janë:</p> <p>UNYT gjithashtu ka dy atelie krijuese ku studentët punojnë mbi projektet e tyre, të pajisura me tavolina të mëdha pune dhe dritare të gjera që ofrojnë ndriçimin e nevojshëm, duke krijuar kushte optimale për vizatimin, punimin dhe prezantimin e projekteve. Laboratori i modelimit (Creative Lab 2) është i pajisur me një makineri për prerjen e materialeve për makete.</p> <p>Institucioni disponon bazën materiale minimale për dizajn (Aneksi 3.11: Liçensat për software), duke ofruar laboratorë të pajisur me programe si Rhino, Adobe Creative Suite (Illustrator, Photoshop, InDesign, Premier, AfterEffects), dhe programe të tjera të përdorura në fushën e dizajnit grafik. Të gjithë laboratorët kompjuterikë janë të pajisur me mjete dhe programe profesionale që lejojnë pedagogët të realizojnë me sukses seanca praktike.</p> <p>Aneksi 4.12: Sipërfaqja në funksion të mësimdhënies East</p> <p>UNYT investon në zhvillimin dhe përmirësimin e lehtësirave të IT-së për të ofruar teknologjitë më të fundit për studentët dhe personelin akademik, duke transformuar klasat në "klasa të zgjuara" me projektorë LCD dhe ekrane projeksioni, lidhje për laptopë dhe sisteme fonike. Megjithatë, një sfidë mbetet distanca nga zona qendrore e Tiranës, që mund të kufizojë aksesin e lehtë për disa studentë dhe staf, për këtë arsye sugjerohet që Departamenti të sigurojë edhe laborator dhe hapësira pune për printimin dhe prodhimin. Ato duhet të përmbajnë printera për metoda të ndryshme printimi (inkjet, lazer, etj.), prerëse letre, makina lidhëse dhe mjete të tjera të përdorura në prodhimin e dizajneve fizike (projekte apo makete).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion laboratorë të pajisur me programe si Rhino, Adobe Creative Suite (përfshirë Illustrator, Photoshop, InDesign, Premier, dhe AfterEffects), si dhe mjete të tjera të rëndësishme për dizajnin grafik. Laboratorët kompjuterikë janë të ngarkuar me mjete dhe software profesional që mundësojnë pedagogëve realizimin e suksesshëm të seancave praktike.</p> <p>Aneksi 4.12: Sipërfaqja në funksion të mësimdhënies East</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>UNYT ka investuar në një infrastrukturë moderne dhe të zgjeruar për të mbështetur programet akademike. Me kampuse të reja dhe ambiente bashkëkohore, ofron hapësira të mjaftueshme dhe pajisje të përditësuara për studentët dhe stafin. Zyra e Teknologjisë së Informacionit ofron mbështetje të plotë për përdorimin e laboratorëve dhe pajisjeve mediatike. Biblioteka e universitetit siguron akses në një koleksion të përditësuar librash. Megjithatë, një sfidë mbetet distanca nga zona qendrore e Tiranës, që mund të kufizojë aksesin e lehtë për disa studentë dhe staf.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Materialet kryesore në gjuhën e programit të studimit përgjithësisht janë të disponueshme në bibliotekën e universitetit. Sidoqoftë, duke qenë se fusha e dizajnit është në një zhvillim të shpejtë, literatura ende kërkon pasurim të mëtejshëm. Literatura e detyrueshme dhe ndihmëse për lëndët e programit Bachelor në Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier”, ofrohet në anglisht dhe rishikohet çdo fillim viti akademik. Blerjet e reja për përditësimin e teksteve miratohen bazuar në buxhetin e Departamentit dhe sipas procedurave përkatëse. Aneksi 2.2 Syllabuset Aneksi 3.27 Plan Buxheti
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	UNYT ka një fond të dedikuar për bibliotekën, i cili varion midis 15,000 dhe 20,000 Euro në vit, dhe është i destinuar për blerjen dhe rifreskimin e literaturës së re akademike. Përveç kësaj, janë ndarë 20,000 Euro për abonime vjetore në burime elektronike dhe biblioteka online. Aneksi 3.27 Plan Buxheti
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita ne institucion u konstatua se studentët e Departamentit të “Arkitekturës dhe Dizajnit”, kanë në dispozicion në godinën e tyre një ambient të veçantë si bibliotekë mësimore, me tekste të fushës, terminale të lidhura me kompjuterin qendror dhe ambiente studimi.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e	Nga vizita ne terren u konstatua se biblioteka e UNYT ofron literaturë akademike dhe ndihmëse për mbështetjen e kurrikulës së universitetit ne teresi dhe te departamentit të “Arkitekturës dhe Dizajnit”. Ajo siguron qasje në literaturë shumëdisiplinore si Ekonomik, Biznes, Shkenca Kompjuterike, Ligje, Sociologji, Histori, etj., në gjuhën shqipe dhe angleze. Gjithashtu, përfshin tema masteri, doktorature, artikuj dhe punime profesorësh. Biblioteka përdor sistemin LibrarySoft për regjistrim dhe sistemin e klasifikimit të Bibliotekës së Kongresit për katalogim. Materialet janë të aksesueshme edhe përmes platformave si Emerald Insight, PROQUEST, EBSCOhost, APA, SAGE, etj., me kosto totale prej 190,000 Euro. Ato mund të huazohen me kartë

specifikës së programit të studimit.	identiteti ose kartë studenti. Më shumë informacion mund të gjendet në: http://library.unyt.edu.al/ .
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Universiteti ka siguruar akses në dy baza të dhënash prestigjioze për kërkim shkencor, EBSCOhost dhe EMERALD Insight, duke mundësuar qasje të gjerë në koleksione të ndryshme. EBSCOhost ofron mbi një milion tituj librash elektronikë, revista shkencore dhe 90,000 libra audio, me një abonim vjetor prej 20,000 Euro që filloi në vitin 2023. Ndërkohë, EMERALD Insight është në përdorim që nga viti 2002 me një kosto prej 4,800 GBP në vit. Përmes një bashkëpunimi me Empire State College, studentët dhe stafi i UNYT kanë akses në baza të dhënash shtesë si JSTORE, PROQUEST, APA, GALE, Sage, dhe të tjera.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Në bibliotekë janë të instaluar 8 kompjutera, të cilat janë vendosur në dispozicion të studentëve. duke u mundësuar atyre kërkimin në internet dhe aksesimin e librave online.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e Fakultetit është e hapur çdo ditë, nga e hënë në të premte, çdo ditë të javës nga ora 09.00- 20.00 dhe në fundjavë deri në orën 18.00. Orari i Bibliotekës është i afishuar në hyrje të bibliotekës dhe në faqen elektronike; [http://unyt.edu.al/facilities-3].
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për	Gjatë veprimtarisë së saj, biblioteka mban statistika të sakta mbi frekuentimin dhe përdorimin nga stafi akademik dhe studentët, të cilat raportohen çdo muaj në Rektorat dhe tek Administratori i UNYT. Me një bashkëpunim të ngushtë me stafin akademik, biblioteka pasuron dhe përditëson fondin e saj të librave dhe materialeve online, duke siguruar gjithmonë një cilësi të lartë të koleksionit. Bazuar ne Aneksin 4.9 Politika dhe Procedura e Bibliotekës: Pasurimi, Biblioteka ka regjistruar: Materiale të kataloguara: 8,559 ekzemplarë Huazimi dhe qarkullimi: 2,183 Lexues të bibliotekës (Universiteti): 420 Përdorues të bibliotekës: 500 Lexues të jashtëm: 153

performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	Biblioteka e Fakultetit ofron një numër të konsiderueshëm të titujve librash në fushën e artit, dizajnit, arkitekturës, historisë së artit dhe fushave të ngjashme si dhe ofron ambiente studimi dhe terminale të lidhura me internet dhe kompjuter që mundësojnë studentëve kërkim në internet dhe aksesimin e librave online.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Sekretaria mesimore menaxhon dhe përditëson të dhënat e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. UNYT ka përdorur sistemin GNOMON që nga viti 2003, por prej vitit akademik 2023-2024 është duke përdorur platformën e re KION. Ky sistem ofron mundësinë e regjistrimit online të lëndëve, hedhjen e vlerësimeve nga stafi akademik, dhe qasje online për studentët për të kontrolluar notat, mungesat dhe të dhëna të tjera akademike.</p> <p>Aneksi 4.1 Rregullore e brendshme për veprimtarinë e sekretarise mesimore</p> <p>Aneksi 4.20 Platforma Gnomon</p> <p>Aneksi 4.21.6 Regjistrimi i studentëve në KION</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Për menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, Zyra e Burimeve Njerëzore ruan dosje fizike dhe elektronike, në përputhje me Ligjin Nr. 9887 dhe udhëzimet për mbrojtjen e të dhënave personale. Pas dorëzimit të dokumenteve nga të sapo punësuarit, hapet një dosje fizike dhe një kopje dixhitale e dokumenteve përditësohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore sipas ndryshimeve ligjore. Sistemi i menaxhimit ofron akses të sigurt për stafin dhe studentët përmes adresave elektronike të krijuara nga Zyra e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit. Stafi akademik dhe studentët kanë llogari dhe kod personal për të aksesuar informacionin akademik dhe administrativ. Zyra e TI-së krijon e-maillet dhe kredencialet për të gjithë përdoruesit e sistemit.</p>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Aneksi 4.19 Adresa elektronike për secilin student</p> <p>Aneksi 4.18 Sistemit I menaxhimit KION</p>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe	Sistemi i menaxhimit (KION) siguron të dhëna mbi studentët dhe plan-programet, të cilat përdoren nga Sekretaria mesimore për nevojat të

<p>module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>ndryshme. Ai gjithashtu mundëson ndërveprimin mes stafit akademik dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit (KION) ofron të dhëna për studentët dhe programet e studimit, të cilat përdoren nga Sekretaria mësimore për qëllime të ndryshme. Ai gjeneron lista të studentëve dhe notave, si dhe të dhëna për ecurinë akademike në UNYT. Përveç këtyre, sistemi siguron të dhëna për raportime të ndryshme që i nevojiten Sekretarisë për analizë statistikore.</p> <p>Aneksi 4.21.2 Hedhja e mungesave në KION</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen e internetit të institucionit 'Universiteti i New York-ut (UNYT) jepen informacione lidhur me programin e studimit Bachelor në Dizajn. Faqja ofron informacion mbi stafin e Departamentit që ofron këtë program, si dhe aktivitetet e tyre të ndryshme, të përditësuara.</p> <p>Në faqen zyrtare të UNYT, e cila mund të vizitohet në https://unyt.edu.al/, pasqyrohen të gjitha informacionet e nevojshme për studentët dhe të interesuarit. Kjo faqe ofron një panoramë të plotë mbi universitetin, duke përfshirë detaje mbi Menaxhimin, Historikun dhe Vlerat, si dhe informacion të thelluar për programet akademike, strukturën e kurikulës dhe politikat e bursave. Ajo gjithashtu ofron akses në shërbimet për studentët, si Zyra e Karrierës dhe Qendra e Këshillimit Studentor, dhe ofron lidhje të dobishme për menaxhimin e aktiviteteve akademike dhe sociale. Për më tepër, faqja informon mbi lajmet dhe eventet në universitet dhe është në zhvillim e sipër për të ofruar një përvojë më të pasur dhe të mirë-strukturuar në anglisht dhe shqip. Faqja e internetit të Universitetit aktualisht është e disponueshme në gjuhën angleze.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Menaxhimi Online dhe Transparenca për Studentët: Sekretaria mesimore përdor një sistem online të avancuar që u jep studentëve mundësinë të shikojnë dhe monitorojnë informacionin e tyre akademik, duke rritur transparencën dhe lehtësuar aksesin.</p> <p>Ruajtja e Informacionit dhe Ndërveprimi Online: Ruajtja e të dhënave për personelin dhe partnerët është e rëndësishme dhe praktika e mirë. Komunikimi dhe bashkëpunimi online përmes postës elektronike janë efikas në kohë reale.</p> <p>Disponueshmëria e Faqes së Internetit: Faqja e internetit është e disponueshme vetëm në anglisht, që është një mangësi, pasi kufizon informacionin për ata që nuk dinë anglisht por duan të regjistrojnë fëmijët e tyre në këtë universitet.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UNYT përgatit një raport vjetor për kosto-efektivitetin e çdo programi studimi duke analizuar shpenzimet operacionale dhe kapitale. Analiza e kostos përfshin shpenzimet për mësimdhënie, pagat e stafit, dhe shpenzimet e tjera si qiraja dhe energjia. Shpenzimet kapitale përfshijnë kostot për pajisje, mobilie, dhe licenca për programe kompjuterike. Analiza krahasohet me të ardhurat e gjeneruara nga programet për të përcaktuar fitimin ose humbjen, dhe bëhen modifikime për vitin e ardhshëm nëse është e nevojshme.</p> <p>Aneksi 4.33 Pasqyrat Financiare 2021 Aneksi 4.33.1 Pasqyrat Financiare 2022 Aneksi 4.31 Kosto-efektivitet</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Burimet financiare të Universitetit të New York Tirana për aktivitetin akademik dhe kërkimor përfshijnë tarifën e studimeve, financimet nga Fondacioni, dhe të ardhurat nga projektet kërkimore. Shpërndarja e këtyre burimeve bazohet në buxhetin e miratuar në fillim të vitit akademik. Procesi i planifikimit buxhetor fillon në Prill-Maj dhe njësitë organizative/departamentet marrin një format buxheti në formë elektronike për të përgatitur buxhetin e kërkuar. Ky buxhet duhet të përfshijë regjistrin e personelit, nevojat për pajisje dhe fonde për aktivitete zhvilluese dhe kërkimore. Pas përgatitjes, buxheti miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i UNYT.</p> <p>Aneksi 3.27 Plan Buxheti Aneksi 4.32 Procedura e Buxhetimit</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Zyra e Financave e Universitetit të New York-ut në Tiranë përfshin një auditim vjetor nga një kompani e pavarur për të siguruar që operacionet dhe raportimet financiare të jenë të sakta dhe në përputhje me politikën dhe ligjet. Ky auditim shqyrton shpenzimet dhe të ardhurat, monitoron përdorimin e sistemeve ERP dhe teknologjive të tjera, dhe vlerëson përputhshmërinë me rregulloret fiskale dhe kontabël në Shqipëri. Kështu, sigurohet që çdo transaksion të jetë i saktë dhe në përputhje me standardet e kërkuara.</p> <p>Aneksi 4.30 Raporti i Auditit të Jashtëm 2021 Aneksi 4.30.1 Raporti i Auditit të Jashtëm 2021</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në fund të çdo cikli studimi, UNYT përgatit një raport financiar përmbledhës për të vlerësuar nëse programi i studimit ka ndjekur planin origjinal ose nëse është e nevojshme një rishikim i situatës financiare. Plani për vitet e ardhshme bazohet në nevojat dhe kërkesat e reja. Dokumentet dhe raportet financiare ruhen sipas ligjit Nr. 25/2018 dhe përdoren sipas kërkesave të drejtuesve të institucionit/programit.</p> <p>Aneksi 4.33 Pasqyrat Financiare 2021 Aneksi 4.33.1 Pasqyrat Financiare 2022</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UNYT ka ndërtuar një sistem të fuqishëm për menaxhimin financiar, i cili përfshin ndjekjen e standardeve të kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të qarta dhe në kohë. Çdo vit, organizata zhvillon një buxhet të detajuar që përfshin të gjitha kostot dhe burimet e financimit, dhe e monitoron atë për të siguruar që të gjitha të dhënat janë të sakta. Parashikimet e rrjedhës së parasë dhe barazimet mujore ndihmojnë në menaxhimin efektiv të financave, ndërsa financimi i vazhdueshëm nga Fondacioni siguron stabilitet dhe zhvillim të qëndrueshëm për programet e studimit.</p> <p>Aneksi 4.33 Pasqyrat Financiare 2021 Aneksi 4.33.1 Pasqyrat Financiare 2022</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni deklaron se situata financiare dhe bankare është e qëndrueshme gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, dhe disponon kapacitet financiar të mjaftueshëm për përmirësimin e vazhdueshëm dhe për të gjeneruar të ardhura në të ardhmen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e</p>	<p>UNYT bazuar të Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Universitetit (Aneksi 1.1), Regulloren e Universitetit (neni 62) (Aneksi 1.7) dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Rregullore e Zyrës së Cështjeve Studentore (Aneksi 5.1) ka hartuar kriteret bazë për pranimin e studentëve në universitet.</p> <p>Sipas dokumentacionit të paraqitur nga RVB (Anekset 5.2; 5.2.1 ; 5.2.2 dhe Aneksi 5.2.3) vërejmë që pranimi i studentëve nis me përcaktimin e kriterëve dhe kuotave nga Senati Akademik i UNYT te cilat bazohen në kapacitetet infrastrukturore dhe akademike që departamenti ofruet ka në dispozicion.</p> <p>UNYT informon maturantët për kushtet dhe mundësitë që ofron universiteti me anë të aktiviteteve të ndryshme: Ditët e hapura dhe Vizitat e Studenteve; Kurset e Matures; Panaire të punës dhe studimit si dhe Provimi i Burses (Anekset 5.4; 5.5; 5.6 dhe 5.8)</p> <p>Aplikimi dhe regjistrimi i maturantëve UNYT kryhet përmes raundeve sipas kalendarit të përcaktuar nga MAS dhe Institucionet në varësi të saj. (Anekset 5.9 dhe 5.9.1)</p> <p>Çdo student i pranuar në UNYT, pajiset me numër matrikullimi nga QSHA dhe konsiderohet student me të drejtat dhe detyrimet sipas rregulloreve përkatëse, si dhe paisen me kartën e studentit (Aneksi 5.24) dhe ID e studentit (Aneksi 5.24.1)</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UNYT zbaton politika të mundësive të barabarta për të gjitha programet e tij (Statuti i UNYT neni 6 “Liria Akademike dhe Mundësitë e Barabarta” Aneksi 1.1)</p> <p>Në Rregulloren e programit (Aneksi 1.10) detajohen procedurat dhe praktikatat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi dhe deri në përfundimin e studimeve, që garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët.</p> <p>RVJ vëren se UNYT ka ngritur në rang universiteti Këshillit e Etikës (Kodi i Etikës Aneksi 3.1); Qendrën e Mbështetjes Akademike dhe të Këshillimit (Aneksi 3.2), si dhe zotëron një faqe webi https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/, të gjitha këto për të garantuar të drejta të barabarta për të gjithë studentët, gjatë tërë periudhës së dtudimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret</p>	<p>Nga vëzhgimet në portalin UAlbania, GVJ konstaton që Departamenti i “Arkitekturës dhe Dizajnit” ka përcaktuar dhe publikuar kriteret e pranimit të aplikantëve studentë në portalin e Maturës Shtetërore. Kriteri i mesatares sipas VKM mbi 6.5 dhe si kriter i veçantë mbetet gjuha e huaj meqë studimet kryhen në gjuhën angleze (anekset 5.2; 5.2.1, 5.2.2 dhe 5.2.3).</p> <p><i>Në anekset 5.3; 5.3.1 dhe 5.3.2 për programet e ciklit të parë (në veçanti dhe për programet e Dizajnit) vihen re kuota dhe për studentët të huaj.</i></p>

parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret e pranimit në programin e studimit “Dizajn” janë të publikuar në faqen zyrtare të UNYT.</p> <p>Këto kriteret u paraqiten gjithashtu studenteve kandidatë verbalisht gjatë takimit në zyrën e çështjeve të studentëve (SAO). (Aneks 5.2.1; 5.2.2 dhe 5.2.3) dhe janë në përputhje me nenin 74 të ligjit nr. 80/2015 në Ligjin për Arsimin e Lartë.</p> <p>Në rastin e studentëve me një diplomë të huaj është e nevojshme ekuivalentimi sipas akteve ligjore dhe nënligjore. (Aneksi 1.10, neni 8)</p> <p>Nëse gjuha amtare e një aplikanti nuk është anglisht, ai / ajo duhet të paraqesë dëshmi të aftësisë në anglisht (TOEFL, IELTS, TOEIC, APTIS në nivelin B1/B2) sipas Vendimit të Senatit nr. 89, datë 27.01.2023. (Aneksi 5.2)</p> <p>Për ta bërë më të aksesueshëm pranimin në UNYT, universiteti mundëson për të gjithë kandidatët zhvillimin e provimit të gjuhës angleze në bashkëpunim me British Council/ APTIS në ambientet e UNYT.</p> <p>Për përparimin përgjatë kursit të studimit, UNYT ndihmon studentët në përmirësimin e njohurive të tyre gjuhësore përmes kurseve të “English as Second Language” (ESL).</p> <p>Për regjistrimin në UNYT, në zbatim të kërkesave ligjore, çdo kandidat duhet të sjellë pranë sekretarisë mësimore dokumentat e listuara më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Formularin e aplikimit ● Kopje të noterizuara të diplomës dhe listës së notave të shkollës së mesme ● Një kopje e ID ose pasaportës ● 4 fotografi (madhësia e pasaportës). ● Certifikata e mbrojtjes së gjuhës Angleze (B1/B2) (kriter I UNYT) <p>Në rregulloren e programit të studimit “Dizajn” neni 9, janë procedurat e transferimit të studentëve në kë program dhe janë në përputhje me rregulloren e UNYT dhe Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë. (Aneksi 1.10, fq 7)</p> <p>Për procedurat e transferimit studenti duhet të sjellë listën e notave dhe pershkrimin e secilës lëndë (silabuset) që ka marrë në universitetin ku aktualisht ndjek studimet.</p> <p>Më tej Komisioni i Vlerësimit të krediteve llogarit sasinë e krediteve që do ti njihen studentit në UNYT. (Aneksi 3.35)</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p>RVJ konstaton që UNYT nëpërmjet faqes zyrtare të Web (www.unyt.edu.al), informon publikun, studentët e ardhshëm, studentët aktiv dhe stafin e Universitetit në mënyrë të detajuar për UNYT, (strukturën e tij akademike, programet e studimit, kurrikula si</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>dhe me të gjitha veprimtaritë e zhvilluara me karakter akademiko-shkencor, social, kulturor si dhe aktivitetet studentore. https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/ RVJ konstaton që UNYT komunikon me publikun përmes reklamave të ndryshme në TV / gazeta / radio. UNYT është shumë aktiv në organizimin e aktiviteteve arsimore të një natyre promovuese, si broshura, fletëpalosje, student book të cilat përditësohen në mënyrë periodike për të reflektuar zhvillimin e institucionit dhe programeve të tij. Me anë të pjesëmarrja në panairët e organizuara nga dhoma e tregtisë në qytetet e Shqipërisë dhe mirëpritjes herë pas here në ambjentet e universitetit, UNYT informon studentët kandidatë mbi programet dhe ambjentet që do kenë nëse do zgjidhin UNYT. (Aneksi 5.6 dhe Aneksi 5.25) UNYT organizon aktiviteteve të ndryshme si Kurset e Maturës (online, për lëndët Matematikë, Gjuhë, Letërsi dhe Anglisht Aneksi 3.25 dhe Aneksi 5.5), Kurset e Arkitektures (online dhe fizikisht), Provimi i Bursës (Aneksi 5.8) etj, u jep mundësi maturanëve që të përgatiten për provimet e maturës, të informohen rreth UNYT, si dhe mundësi studentëve ekselente të përfitojnë deri në 100% bursë.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Duke shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga RVB, RVJ konstaton që UNYT përcakton kuota për kategori me aftësi të veçanta në përputhje me kriteret e vendosura nga Ministria e Arsimit në udhëzimin nr.10, datë 30.06.2023. (Anekset 5.3; 5.3.1 dhe 5.3.2). UNYT zbaton politika lehtësuese për shtresat në nevojë duke zhvilluar provimin e bursës (Aneksi 5.8) disa herë në vit dhe duke aplikuar Politikën e Bursave, përgjatë vitit akademik UNYT nëpërmjet peticioneve financiare mundëson lehtësimin e pagesave sipas rasteve përkatëse. (Aneksi 5.30.1).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Sipas udhëzimeve të Ministrisë UNYT publikon kuotat për kategoritë e studentëve me shtetësi të huaj përpara çdo viti akademik bazuar në historikun e kërkesave gjatë viteve paraardhëse. Aneksi 5.3, Aneksi 5.3.1 dhe Aneksi 5.3.2. Kriteret e pranimit miratohen me vendim Senati Akademik dhe i dërgohen zyrtarisht Ministrisë së Arsimit dhe për dijeni QSHA si dhe publikohen në faqen zyrtare të U- albania. Në lidhje me përcaktimin e kriterëve shtesë të pranimit, duke qenë se Universiteti i New York-ut në Tiranë ofron programe studimi në gjuhën angleze, zbatohet kriteri i pranimit me testim institucional ose certifikimin përkatës të njohjes së gjuhës angleze për programet e ciklit të parë dhe kriteri i pranimit me certifikimin përkatës të njohjes së gjuhës angleze (niveli B1/B2) për ciklin e dytë, e përcaktuar kjo edhe në Ligjin Nr. 80/2015 “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. (Anekset 5.2.1; 5.2.2 dhe 5.2.3)</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në</p>	<p>Për të rritur cilësinë e pranimit në programet e tij UNYT, pas vlersimit të dokumentacionit të sjellur nga studentët në Zyrën e Çështjeve të Studentëve (SAO) përmes vendimeve të komitetit të bursave ofron mbështetje financiare për maturanët me mestare mbi 9., dhe për arritje</p>

programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	në olimpiada kombëtare dhe ndërkombëtare. (Politikat e bursave seksioni 1, pika 1.3, faqe 3). Sipas politikave të bursave të UNYT, studentët kandidatë fitojnë bursa studimi nga 25% deri në 100%. (Anekset 5.7; 5.7.1 dhe 5.7.2)			
Konkluzione	<p><i>Institucioni ka të përcaktuara qartë kriteret e pranimit për studentët nga Matura Shtetërore dhe ka publikuar këto kriteret. Po ashtu, procedurat për transferim, njohjen e studimeve të mëparshme dhe të pjesshme janë të përfshira në rregulloren e regjistrimit dhe transferimeve, e cila është e disponueshme online për studentët.</i></p> <p><i>Institucioni ka një praktikë të mirë për informimin e maturantëve përmes faqes zyrtare, panairëve, broshurave etj.</i></p> <p><i>Institucioni përcakton kuotat e pranimit duke përfshirë dhe kuota për të huaj dhe kandidatëve me aftësi të veçanta.</i></p> <p><i>UNYT zbaton politika të bursave për maturantët me rezultate të larta dhe bursa speciale për shtresa në nevojë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Rregullorja e programit të studimit bachelor “Dizajn” me profile “Dizajn interieri” dhe “Dizajn Grafik”, (Aneksi 1.10) e cila u vihet në dispozicion studentëve, përcakton kriteret e kalimit nga një vit akademik në tjetrin sipas performancës akademike. Numri i studentëve në tre vite është</p> <p>2021-2022 7 D Grafik/6 D Interior 2022-2023 9 D Grafik/8 D Interior 2023-2024 18 D Grafik/10 D Interior</p> <p>Stafi akademik me kohë të plotë I Departamentit, ka akses në sistemin e menaxhimit për të parë rezultate akademike të studentëve me qëllimin për të ndjekur ecurinë e tyre dhe për të bërë këshillimin e duhur në lidhje me lëndët që studenti duhet të ndjekë në semestrin pasardhës. (Aneksi 4.21.5)</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e	RVJ konstaton se UNYT përmes Zyrës së tij të Çështjeve të Studentëve (SAO) ofron informacion dhe udhëzime të hollësishme mbi procedurat

<p>njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshshme.</p>	<p>e njohjes së diplomës përmes shpjegimit të përmbajtjes së Diplomës dhe certifikatës së maturës shtetërore për studentët e shteteve të tjera.</p> <p>Aneksi 2.9 shpjegon procedurat e transferimit studentëve kandidat. Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO) i komunikon fillimisht studentit që duhet të sjellë listën e notave dhe përshkrimin e secilës lëndë (silabuset) nga universiteti ku aktualisht ndjek studimet si dhe për kushtet e pranimit dhe numrin e krediteve që mund ti njihen në rast të transferimit të studimeve ne UNYT (Aneksi 5.26)</p> <p>Pasi Komisioni i Vlerësimit të krediteve vlerëson sasinë e krediteve që do t'i njihen studentit në UNYT bëhet pranimi i transferimit të studentëve në programin e studimit në përputhje me procedurat e transferimit të studentëve të UNYT dhe Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Për t'u diplomuar, studentët e transferuar duhet të fitojnë të paktën 1/2 të totalit të krediteve në UNYT. (Aneksi 3.35)</p> <p><i>Në Programin e studimit "Dizajn" me profile "Dizajn interieri" dhe "Dizajn Grafik", ka studentë që kanë trasferuar studimet e tyre në këto profile.</i></p> <p><i>(Aneksi 2.1 tabela 21)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>UNYT operon në përputhje me sistemin Evropian të Arsimit të Lartë të Kredive si njësi të matjes së ngarkesës së studentëve. Mënyrat e vlerësimit të njohurive të programit si dhe kriteret e vlerësimit janë specifikuar në Rregulloren e Programit. (Aneksi 1.10) me të cilën njihet çdo student në momentin që ai/ajo regjistrohet në program. Në ndihmë studentëve janë dhe Staf i akademik i Departamentit, Zyra e Regjistrimit dhe Këshilluesi Akademik. (Aneksi 3.6 dhe Aneksi 4.1)</p> <p>Në seksionin 15 të syllabusit të çdo lënde (Anekset 2.1 dh 2.2), të ofruar si pjesë e programit përcaktohe mënyra e vlerësimit të studentëve dhe kriteret e vlerësimit.</p> <p>Një lëndë tipike e programit i vlerëson dijet e përfituara në klasë nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provimit të Ndërmjetëm (30% e notës përfundimtare) - Provimit Përfundimtar (40% e notës përfundimtare) - Pjesëmarrjes aktive të studentit në klasë (10% e notës përfundimtare) - Komponentë të tjerë (20% e notës përfundimtare; ky komponent përbëhet nga një kombinim i detyrave të kursit, rasteve studimore, punës në laborator etj. <p><i>(Aneksi 2.1 Tabelat përmbledhëse; Tabelat 14 dhe 15. Ato janë konform me VKM nr. 41, datë 24.1.2018, dhe VKM nr. 879, datë 18.12.2019</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe</p>	<p>Aneksi 2.11 paraqet rregulloren e posaçme për provimin apo punimin e diplomës në UNYT.</p> <p>Ajo, së bashku me rregulloret e tjera të tilla si Rregulloren e UNYT (Aneksi 1.7 Neni 28, 29), Rregulloren e Fakultetit (Aneksi 1.8, Neni</p>


diplomimit në programin e studimit.	16, 17), Rregulloren e Departamentit (Aneksi 1.9 Neni 15, 16, 17, dhe 18), Rregulloren e Programit të Studimit (Aneksi 1.10 Neni 26, 29, 30) dhe Manuali i projektit të diplomes (Aneksi 2.12) përcaktojnë të gjitha parakushtet dhe procedurat për Projektin e diplomimit. Bazuar në këto rregullore, Departamenti, si strukturë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi, informon studentët lidhur me kriteret e diplomimit me qëllim që t'u krijojë atyre kushtet e nevojshme për realizimin me sukses të programit. <i>Studentët në takimin me GVJ pranuan se ishin të mirëinformuar për procedurat e punimit të diplomës dhe procesin e diplomimit.</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	SAO zyra e pranimit të studentëve në UNYT, në zbatim dhe të shkresave përkatëse të Ministrisë së Arsimit, harton Planin vjetor të veprimit (Aneksi 5.27) ku përfshihen takime me maturantët në ambjentet arsimore përkatëse, vizitorëve të interesuar si dhe nëpërmjet panaireve. Për informimin e studentëve të ardhshëm në lidhje me programin e studimit, UNYT ofron këshillime të përgjithshme studimore si dhe Kurset e Maturës. (Aneksi 5.5).			
Konkluzione	<i>Rregullorja e programit të studimit ofron informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve nga një vit akademik në tjetrin, mbi regjistrimin, transferimet, kriteret e vlerësimit si dhe procedurat e diplomës.</i> (Kjo u konstatua dhe në takimin e GVJ me studentët)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Përgjegjëse për informimin e studentëve është Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO) e cila informon studentët mbi strukturën e programeve në mënyra të ndryshme siç janë e-mailet, takimet në zyrë ose përmes faqes zyrtare https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/ si dhe broshurave apo nëpërmjet dhënies së dosjes së programit të studimit në formatin hardcopy pranë kësaj zyre. Kandidateve u jepet mundësia të zhvillojnë takime edhe me stafin akademik përgjegjës për programin e studimit. Në javën e parë të vitit akademik nga Zyra e Çështjeve të Studentëve studentëve dhe nga adviser/këshilluesi akademik (Aneksi 3.4) u jepet informacion më i detajuar mbi sezonet e provimeve, mënyrën e vlerësimit etj. Ky informacion gjendet edhe në faqen zyrtare të UNYT https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Që në javën e parë të studimeve studenti njihet me të gjithë informacionin e nevojshëm rreth programit të studimit duke pajisur studentët me planin mësimor përkatës nëpërmjet këshilluesit akademik (Aneksi 3.4) dhe Zyrës së Cështjeve tëstudentit SAO. Cdo fillim semestri, studentët njihen me silabuset e lëndëve që do ndjekin. Të gjitha këto informacione studentët mund t'i gjejnë dhe në faqen e internet të UNYT (unyt.edu.al).</p> <p>Gjithashtu, studentët informohen për akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit që ofrohen në UNYT si dhe njohjen e vlefshmërisë së diplomës.</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#internal-decisions</p> <p>(Programit i studimit “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interieri” po i nënshtrohet procesit të Akreditimi për herë të parë.)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Karrieres (Aneksi 5.11; 5.16; 5.22; dhe 5.22.1) pranë UNYT mban kontakte me studentët dhe i informon ata rregullisht mbi mundësitë e tregut të punës në lidhje me praktikat, punët me kohë të pjesshme/të plotë dhe aktivitete të tjera.</p> <p>Zyra e Karrierës pranë UNYT organizon një numër i konsiderueshëm aktiviteteve si ditët e Karrierës, takime informuese mbi mundësitë e punësimit të studentëve në kompani të ndryshme, workshope etj. (Anekset 5.12; 5.12.1 dhe 5.13).</p> <p>Zyra e Karrierës, asiston studentët në sigurimin e sa më shumë mundësive të internshipeve me kompanitë bashkëpunuese, veçanërisht gjatë periudhës së lëndës së detyrueshme të internshipit. (Anekset 5.14; 5.14.1 dhe 5.14.2)</p> <p>Zyrën e Karrierës pranë UNYT organizon çdo vit Panairin e Punës (Aneksi 5.15), në të cilin janë të ftuar të marrin pjesë partnerët e biznesit prej vitesh (Aneksi 5.15.2), në përzgjedhjen e të cilave përfshihen edhe studentët (Aneksi 5.15.1)</p> <p>Në Panairin e Punës një hapësirë e vecantë u është dedikuar Alumni ku të ftuar ishin raste të suksesit të studentëve të diplomuar ndër vite në programe të ndryshme në UNYT (Aneksi 5.17)</p> <p>Ndër vite ka patur mundësi shumë të mira pune që përputhen midis kompanive dhe studentëve të një dege të caktuar studimi si është pasqyruar në dokumentet vjetore të performances (Aneksi 5.18).</p> <p>(Studentët e parë të diplomuar në programin e studimit “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interieri” i përkasin vitit akademik 2023-2024 ndaj nuk ka statistika për punësimin.)</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për</p>	<p>Që gjatë vizitave të tyre në ambientet e e UNYT si dhe në ditët e hapura te organizuara nga universiteti, studentëve dhe / ose kandidatëve u jepet një informacion i tjerë në lidhje me zyrat dhe shërbimet e ndryshme</p>

zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	që ofrojnë në shërbim të studentit Aneksi 5.29 . Në fillim të vitit akademik studentët informohen për zyrat që mund t'i ndihmojnë gjatë studimeve të tyre në UNYT.		
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Që në momentin e regjistrimit të tyre në UNYT, studentët paisen me adresën e tyre elektronike, për të pasur akses në listën e tyre të notave, mungesat e tyre etj., (Aneksi 4.19). Kjo gjë bëhet e mundur online në sistemin e menaxhimit (KION) (Aneksi 4.21.4) aktiv dhe i aksesueshëm lehtësisht nga studentët edhe në distancë.		
Konkluzione	<i>UNYT nëpërmjet Zyrës së Çështjeve të Studentëve (SAO), Zyrës së Karrierës dhe Alumni, si dhe Këshilluesve Akademik u ofron studentëve informacionit të hollësishëm për objektivat dhe strukturën e programit të studimit, infrastrukturën si dhe mbështetje në karrierë. Studentët që ditën e rregjistrimit njihen me performancën e institucionit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Zyra e Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore të UNYT, përgatit çdo vit “Dokumentin e Performancës” dhe përditëson gjatë vitit statistika të përgjithshme për numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, studentët e diplomuar dhe të dhënat e punësimit të tyre. (Aneksi 5.18) Të dhënat përfshijnë statusin e punësimit të studentëve në programet e të gjitha niveleve (Bachelor, Master dhe PhD), informacion mbi përputhshmërinë e punës me drejtimin e studentëve të diplomuar dhe emrat e kompanive/institucioneve ku ata janë pozicionuar. (Aneksi 5.17 dhe 5.20) (Studentët e parë të diplomuar në programin e studimit “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interieri” i përkasin vitit akademik 2023-2024 ndaj nuk ka statistika për diplomimin)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e	Sistemi i menaxhimit KION (Aneksi 4.21) lejon hedhjen e të dhënave personale të studentëve, të dhënave të tyre akademike e financiare (Aneksi 4.21.6). Sipas nevojave, në sistem përditësohen të dhënat për ecurinë e studentëve deri në diplomim Anekset 4.21.; 4.21.3 dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>4.21.5. Nëpërmjet sistemit të menaxhimit gjenerohen të dhëna që shërbejnë për raportime të ndryshme, apo edhe të dhëna statistikore që Sekretaria mësimore kryen në zbatim të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ASCAL-it apo QSHA-së, etj. (Aneksi 2.1 tabela 21 dhe 23) (kjo u konstatua dhe gjatë takimit të GVJ me përfaqesues të sekretarisë mësimore.</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat e studentëve menaxhohen përmes platformës së brendshme KION të UNYT. Departamentet që kanë akses në këtë platformë menaxhimi kanë akses të kufizuar. Njësi e autorizuar për hedhjen, verifikimin dhe ruajtjen e të dhënave është Sekretaria mësimore, e cila lehtësisht mund të përdorë platformën dhe siguron raporte statistikore sipas kërkesave të ndryshme të MAS ose Institucioneve në varësi të saj. (Aneksi 4.21) (Verifikimi gjatë takimit me përfaqesues të sekretarisë mësimore, gjatë vizitës në institucion).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>UNYT ka ngritur një komision ad-hoc me qëllim auditimin e brendshëm të njësive administrative (Aneksi 6.20). Ky komision, si pjesë integrale e kontrollit të brendshëm dhe njësi e specializuar e saj, ka për mision kontrollin e proceduarve dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të zyrave administrative. (Aneksi 6.8)</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Zyra e Sekretarisë Mësimore në bashkëpunim me Departamentin përkatës harton raporte të ndryshme analitike përsa i përket numrit të studentëve në hyrje dhe në dalje (Aneksi 3.8 fq 21 dhe Aneksi 3.9 fq 21). Gjithashtu, Zyra e Karrierës dhe Alumnit përfshihen në procesin e krijimit të raporteve të ndryshme mbi profilet e studentëve të ardhur dhe aktualë dhe shkallën e punësimit të tyre (Anekset 5.20; 5.20.1; 5.20.1 dhe 5.21.1) (Studentët e parë të diplomuar në programin e studimit “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interieri” i përkasin vitit akademik 2023-2024 ndaj nuk ka statistika për punësimin)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se UNYT ka ngritur një sistem të përhershëm të monitorimit dhe kontrollit, duke përfshirë raportimin nga njësia bazë dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni. Kjo mund të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së programit dhe në adresimin e çështjeve të mundshme në përparimin dhe suksesin e studentëve. <i>Studentët e parë</i></p>

	<i>të diplomuar në programin e studimit “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interieri” i përkasin vitit akademik 2023-2024 ndaj nuk ka statistika për diplomimin dhe punësimin e studentëve të këtij program., por dokumentacioni I institucionit dëshmon për praktikatat të mira dhe premtuese.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në statutin e UNYT (Aneksi 1.1, neni 67) parashikohet pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrjet institucionale. Në Rregulloren e Universitetit (Aneksi 1.7 neni 75) parashikohet përfshirja e studentëve të emëruar nga Unioni i Këshillit Studentor, në Organe vendimmarrëse të Universitetit. Aneksi 2.7 tregon për përfshirjen e studentëve në GVB për të gjitha programet që i nënshtrohen procesit të akreditimit (edhe në GVB e programit “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri”, njëri prej anëtarëve është student). Studentët e UNYT përfaqësohen në Senat, NjsBC dhe në Këshillin i Etikës. (Aneksi 2.7.1)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët e UNYT nëpërmjet Unionit Studentor kanë përzgjedhur përfaqësuesit e tyre në disa komisioneve në të cilën japin kontributin e tyre. Studentët përfaqësohen në organin më të lartë si Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Këshilli i Etikës, (Aneksi 2.7.1) si dhe një përfaqësues i studentëve është pjesë e Grupit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm gjate procesit te Akreditimit për çdo program. (Aneksi 2.7).
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në	Përfaqësimi i studentëve në Senatën Akademik dhe Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UNYT, i bën ata pjesë aktive në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. (Aneksi 2.7 dhe Aneksi 2.7.1). Në dokumentet (anekset 6.9; 6.9.1; 6.9.2 6.9.3; 6.9.4 dhe 6.9.5) të paraqitur në RVB për programin Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri” evidentohet përfshirja e studentëve në plotësimin e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	pyetësorëve të zhvilluar çdo semestër ku studentët shprehin mendime e sugjerime për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulave.			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>UNYT ka të hartuar formën dhe procedurat të shqyrtimit të ankimimeve nga studentët. (Aneksi 6.13). Studentët e UNYT kanë të drejtë ankimojnë si për çështje akademike (Aneksi 3.36), ashtu dhe për çështje administrative (Aneksi 5.30)</p> <p>Studenti i UNYT ka mundësi për ankimimi në dy mënyra; fizikisht pranë zyrës së Çështjeve të Studentëve si dhe elektronikisht në faqen zyrtare të web. https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/ (GVJ konstaton që faqja e ankimimit është aktive).</p> <p>Zyra e SAO grumbullon të gjitha evidencat dhe dokumentacionet në lidhje me kërkesën dhe/ose ankesën që ka studentit dhe paraqet kërkesën ose/dhe ankesën tek komiteti i peticioneve akademike ose administrative që është i përbërë nga 3 pjestarë. Komiteti i peticioneve në bazë të evidencave dhe dokumentacioneve merr vendimin nëse peticioni pranohet ose refuzohet. Studentit njoftohet për vlerësimin e peticionit në rrugë elektronike si dhe verbalisht nga Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO).</p> <p>Studentët e pyetur në takimin me GVJ, vlerësonin ambientin pozitiv dhe nuk paraqitën ankesa për vlerësimin.)</p>			
Konkluzione	Studentët në UNYT janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse të universitetit (senat, NjSBC, këshillin e Etikës) dhe marrin pjesë aktive në vlerëmin dhe përmirësimin e programit të studimit nëpërmjet plotësimit të anketimeve, peticioneve të ndryshme si dhe pjesëmarrjes në hartimin e RVB së programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UNYT ka në shërbim të studentëve Zyrën e Çështjeve të Studentëve (SAO), detyrat dhe përgjegjësite e së cilës janë të përshkruara në statutin e UNYT (Aneksi 1.1, neni 48) dhe në Rregulloren e UNYT (Aneksi 1.7 , neni 46). Kjo Zyrë (SAO) zotëron rregulloren e saj (aneksi 5.1) dhe vepron në bazë të rregulloreve, udhëzimeve dhe vendimeve të organeve kompetente të UNYT, si dhe të Ministrisë së Arsimit.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre	Përgjegjëse për informimin e studentëve në UNYT është Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO), (Aneksi 5.1). SOA informon studentët mbi strukturën e programeve, kohëzgjatjen e programit, tarifën e studimit etj. nëpërmjet e-maileve, takimet në zyrë ose përmes faqes zyrtare https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/ (GVJ konstaton që faqja është aktive)

<p>për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në faqen e web, https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/ si dhe nga instruktori i secilës lëndë (Aneksi 3.3) studentët e UNYT informohen që në javën e parë të vitit akademik informohen mbi sezonet e provimeve, mënyrën e vlerësimit.</p> <p>Këshilluesi akademik (Aneksi 3.4) pjesë e departamentit të programit që studenti ndjek në një bashkëpunim të vazhdueshëm me SOA informon studentin mbi planin mësimor, modulet dhe përmbajtjen e lëndëve që programi ka. Cdo fillim semestri, studentët njihen me silabuset e lëndëve që do ndjekin.</p> <p><i>Këto informacione gjenden edhe përmes faqes në internet të UNYT (unyt.edu.al).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në UNYT funksionon Zyra së Karrierës puna e së cilës bazohet në Statutin e UNYT Aneksi 1.1 (neni 55) si dhe rregullores së zyrës së karrierës (Aneksi 5.11).</p> <p>Zyra e Karrierës së UNYT, si rezultat i komunikimit me tregun e punës vendas e ndërkombëtar u ofron studentëve informacionet e ardhura nga organizatat e institucionet me të cilat UNYT ndërvepron.</p> <p>Zyra e Karrierës së UNYT vepron prej shumë vitesh në universitet. Ajo harton plane vjetore (Aneksi 5.16 dhe 5.16.1 për orientuar studentët drejt tregut të punës në përgatitje të liderëve të së nesërme si dhe informon studentët për oferta pune (Aneksi 5.19). Ajo mban kontakte me studentët dhe grumbullon informacione për punësimin e tyre pas diplomimit, si dhe harton raportet përkatëse (Anekset 5.22 dhe 5.22.1). Në këto raporte GVJ konstaton shkallë të lartë të punësimit të Studentëve të diplomuar. <i>(Programi Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri” diplomon studentë për here të parë gjatë vitit akadenik 2023-2024 ndaj nuk ka statistika për punësimin e tyre)</i></p> <p>Zyra e Karrierës bashkëpunon me zyrën e Marrëdhënieve me Publikun, për publikimin e informacionit në gjitha kanalet e komunikimit, duke përfshirë median e shkruar, faqet e internetit, mediat sociale etj. (Aneksi 5.19). Zyra është përherë e aksesueshme nga ana e studentëve të UNYT (Aneksi 5.19.1) si dhe e atyre të diplomuar https://unyt.edu.al/index.php/career-service-office/</p> <p>Zyra e Karrierës e UNYT ndërmjetëson memorandume të shumta mirëkuptimi me organizata publike dhe jopublike (Aneksi 5.10), duke synuar institucionalizimin ligjor të partneritetit me shumë biznese për çdo drejtim studimi në të gjithë ciklin e studimit.</p> <p>UNYT si dhe Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit ka marrëveshje me një numër të konsiderueshëm organizatsh publike dhe jopublike (Tabelat permbledhëse sipas ascal, Aneksi 2.1 tabela 5)</p> <p>Në ambjentet e UNYT, në funksion të komunikimit të çdo njoftimi në një kohë të shkurtër, ekziston Këndi Informues (Aneksi 5.23) ku studentët të kontaktojnë direkt me informacionin.</p>



	Zyra e Karrierës mban komunikime të vazhdueshme me Zyrën e sigurimit të Cilësisë si dhe me departamentin e programeve përkatëse, në lidhje me komente e feedback të marra nga ana e punëdhënësve apo partnerëve të biznesit në lidhje me përmirësime apo përforcime të mundshme të programet të studimit të UNYT.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Karrierës dhe Alumni e UNYT zotëron një databazë të të gjithë studentëve të cikleve të studimit të diplomuar, për nivelin e punësimit të të diplomuarve në nivel program dhe viti akademik. Zyra e Karrierës dhe Alumni dhe Sekretaria Mësimore hartojnë statistika mbi punësimin e studentëve të të gjitha niveleve pas diplomimit (Aneks 5.18; 5.20; 5.20.1; 5.21 si dhe 5.21.1) Ky informacion ndahet me të gjithë drejtuesit e programeve, me Dekanët dhe Rektoratin si dhe është pjesë e dokumentacionit me anë të së cilës pajiset çdo student i ri që regjistrohet në UNYT. Zyra e Karrierës e UNYT mban një komunikim të vazhdueshëm aktiv me studentët, me të diplomuarit e ardhshëm që nisin dhe mbështesin punësimin e tyre dhe madje edhe me studentët e diplomuar ndër vite, Alumni. (Aneksi 5.17.1 dhe https://unyt.edu.al/index.php/job-gate/)			
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në Planin Strategjik për periudhën 2020-2025 (Aneksi 1.6 fq.3) UNYT thekson se një ndër objektivat kryesore të tij është përdorimi I një larmie metodash inovatore mësimdhënie, mësimnxënie dhe kërkim. Në strategjinë e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit (Aneksi 6.18) në pikën 3; 3.1 dhe 3.1.1 konfirmon

	<p>rishikimin e kurrikulave për programet Bachelor me synim përmirësimin e tyre në përmbushje të nevojave të tregut.</p> <p>Në programin <i>Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri”</i> ende nuk janë aplikuar ndryshime kurikule meqë është program i ri (Aneksi 2.1. Tabelat përmbledhëse, tabela 11).</p> <p>Stafi i Departamentit ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga NjSBC dhe ekspertë të jashtëm për metodat bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe UNYT ka nxitur mobilitetin e stafit akademik me universitete prestigjioze (Aneksi 1.31).</p> <p>UNYT i dedikon një hapësirë e veçantë trajnimit të personelit akademik që jep mësim për herë të parë nga drejtuesit e departamenteve, duke përcjellë praktikën më të mira dhe eksperiencat e tyre te akademikët e rinj dhe trajnimit për kurrikulat. Takimet e departamentit bëhen në fillim të vitit akademik dhe gjithashtu në bazë të nevojës për të siguruar që stafi akademik të integrohet plotësisht me politikën dhe procedurat dhe politikën e UNYT.</p> <p>(Aneksi 6.18 pika 2; dhe Aneksi 6.12)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Struktura përgjegjëse të UNYT që zhvillojnë, monitorojnë dhe përmirësojnë cilësinë në mësimdhënie janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) (aneksi 1.1 Statuti, Neni 32, aneksi 2.1 Tabela 24 dhe aneksi 6.19); Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) (Aneksi 1.1 Statuti , Neni 33; aneksi 6.1 dhe aneksi 6.7) si dhe Departamentet përkatëse në secilin Fakultet. KPSSC është përgjegjës për koordinimin e procedurave të përgjithshme, për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike dhe mbështetëse për studentët, në mënyrë që të garantojnë pajtueshmërinë me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, duke siguruar një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në UNYT në bashkëpunim me të gjithë partnerët e tij institucionalë. është i përbërë nga kryetari dhe 6 anëtarë, që përfaqësojnë të gjitha fakultetet dhe studentët (Aneksi 6.3).</p> <p>NjSBC me monitorim KPSSC harton pyetësorë për studentët të cilët vlerësojnë pedagogun dhe lëndën të cilën po ndjekin (Aneksi 6.9). Këta pyetësorë kryhen normalisht dy herë në vit (Aneks 6.9.1 dhe aneksi 6.9.2). Për personelin akademik që jep mësim për herë të parë, vlerësimi nga studentët aplikohet dy herë në semester (aneks 6.9.3). Rezultati i performancës për stafin akademik i vihet në dispozicion rektoratit, dekanëve të fakultetit, departamenteve si dhe pedagogëve përkatës, me qëllim përmirësimin e cilësisë duke marrë parasysh sugjerimet e studentëve (Aneksi 6.9.4; aneks 6.9.5, dhe aneksi 6.9.6).</p>

	<p>Në nivel njësie bazë të gjitha aktivitetet e Departamentit e veçanërisht ato që i përkasin rritjes së cilësisë, përfshihen në Raportin Vjetor të NjSBC (Anekset 6.2; 6.2.1 dhe 6.2.2)</p> <p>Përveç pyetësorëve të plotësuar nga studentët UNYT aplikon edhe mekanizma të tjerë monitories, procesi i vlerësimit të kolegëve si dhe procesin e vetëvlerësimit perkujdrejt objektivave të vendosura në fillim të vitit akademik. Diskutimi mbi raportin e vetvlerësimit kryhet në prani të Përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit në fund të vitit akademik dhe shërben për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit akademik në përgjithësi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>UNYT aplikon metoda për përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve, duke organizuar në menyrë periodike procesin e vlerësimit nga studentët. NJSBC zhvillon pyetësorë (Aneksi 6.9) në mënyrë të vazhdueshme (Anekset 6.9.1 6.9.2 dhe 6.9.3) me studentët ku vlerësohet cilësia në mësimdhënie, si dhe mblidhen sugjerimeve që shërbejnë për përmirësimin e institucionit. Këto pyetësorë plotësohen në anonimat të plotë nga studentët.</p> <p>UNYT zhvillon online/on site (Aneksi 6.14 dhe https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/) formën e peticioneve/ankimeve me natyrë akademike dhe administrative. Senati Akademik ka ngritur një komision të përhershëm (Aneksi 6.13) i cili pasi shqyrton vendos për zgjidhjen e duhur të situatave të caktuara.</p> <p><i>(Studentët e pranishëm në takimin me GVJ nuk kishin ankesa për mënyrën e vlerësimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>KPSSC si dhe NjSBC në kuadër të transparencës së institucionit bën të mundur publikimin e raporteve përfundimtare të vlerësimit të jashtëm të Institucionit dhe të programeve të studimit në faqen zyrtare të UNYT. https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fe17a337-53fb. <i>(Programin "Dizajn" me profile "Dizajn Grafik" dhe "Dizajn interieri" aplikon për here të pare për akreditimin nga ASCAL)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në fillim të vitit çdo anëtar i stafit të UNYT plotëson një objektiv vjetor individual, duke përcaktuar qartë objektivat e tyre në mësimdhënie dhe kërkim shkencor (Aneksi 6.10). Në fund të vitit, Dekani dhe Drejtuesi i Njësisë Bazë i kërkojnë anëtarit të stafit të shpjegojë se si janë përmbushur objektivat e përcaktuara në fillim të vitit dhe cilat janë aspiratat e tyre të ardhshme.</p> <p>Disa nga instrumentat përkatëse që UNYT përdor për vlerësimet e stafit akademik janë: vlerësimet nga kolegët (Aneksi 6.4) dhe studentët (aneksi 6.9), takimet e këshillit të fakultetit dhe departamentit, takimet personale me stafin akademik.</p> <p>Nga vlerësimet e marra hartohet një raport vlerësimi i performancës</p>

	individuale me komentet dhe sugjerimet që i përcillen Rektoratit. Rektorati shqyrton raportet (Aneksi 6.6) dhe në bazë të performancës vendos mbi mënyrat e promovimit të stafit akademik. UNYT mbështet, nxit dhe promovon kërkime shkencore në stafin e saj (Aneksi 4.29). Për promovimin e stafit akademik UNYT alokon një buxhet për pjesëmarrjen në konferenca dhe botime nga stafi akademik. (Anekset 3.27; 3.7 dhe 3.7.1)			
Konkluzione	UNYT ka ndërtuar strategji për garantimin e cilësisë së mësimdhënies duke përfshirë metoda të reja interactive si dhe shkembime të stafit me universitete ndërkombëtare. Nëpërmjet strukturave të KSSC dhe NJSBC garantohej monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies. Me anë të plotësimit të anketimeve dhe peticione garantohej përfshirja e studentëve në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. UNYT promovon personelit akademik si dhe mbështet kërkimin shkencor me anë të buxhetimit të pjesëmarrjes në konferenca dhe për botime shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UNYT në Statutin e tij (neni 32) (Aneksi 1.1) dhe Planin Strategjik 2020-2025 (aneksi 1.6), UNYT përcakton si qëllimi strategjik kryesor përppjeket për përsosmëri akademike në mësimdhënie, bursa dhe shërbime, duke i'u përmbajtur standardeve më të larta të cilësisë në mësimdhënie. Politika dhe procedurat, për arritjen e objektivave të UNYT ndiqen dhe implementohen nga dy strukturat përgjegjëse që janë KPSSC dhe NJSBC. Për mbështetjen përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, KPSSC Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, ka hartuar dhe rregulloren e KPSSC (aneksi 6.3), Manualin e Sigurimit të Cilësisë (aneksi 6.1) si dhe Rregulloren për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (aneksi 6.7).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin	Me qëllimin e sigurimit të cilësisë prej vitit 2012 e në vazhdim UNYT ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Cilësisë (në vazhdim NJSBC) si dhe Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë (në vazhdim KPSSC). NJSBC funksionon bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Institucionit (Aneksi 6.1), si dhe Rregulloret për NJSBC (Aneksi 6.7)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (0) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>si dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë (Aneksi 6.1). NjsBC përbëhet nga staf me eksperiencë në sigurimin e cilësisë i cili orienton punën drejt cilësisë së edukimit.</p> <p>KPSSC përbëhet zgjidhet nga Senati Akademik dhe përbëhet nga 6 anëtarë (Aneksi 6.19) që janë pjesë e personelit akademik dhe një përfaqësues studentësh, siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies (Aneksi 6.3), në bashkëpunim me NjsBC e cila është e kompozuar me 2 anëtar të stafit administrativ dhe një ekspert i jashtëm me profil akademik (Aneksi 6.5).</p> <p>(Aneksi 2.1 Tabelat përmbledhëse, Tabela 24)</p> <p>KPSSC dhe NjsBC së bashku janë përgjegjëse për koordinimin e procedurave të përgjithshme për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike dhe mbështetëse për studentët në mënyrë që të garantojë pajtueshmërinë e kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>NjsBC së bashku me fakultetet dhe departamentet organizon dhe finalizon “formën e vlerësimit për performacën e pedagogut” për secilin program dhe lëndë.</p> <p>Studentët e UNYT përfshihen në këtë proces edhe si anëtar të NjsBC, pra marrin pjesë në hartimin e pyetësorëve, dhe si aktorë përgjatë vlerësimit të pedagogëve për secilën lëndë.</p> <p>Pedagogët ju nënshtrohen 4 formave të vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti i Vlerësimit të Studentëve, (anekset 6.9; 6.9.1; 6.9.2; 6.9.3 dhe 6.9.6) (NjsBC organizon çdo semestër pyetësorë në lidhje me organizmin e programeve të studimit, pedagogët dhe lëndët që ata japin, përmirësimin e cilësisë në metodologjinë e përdorur, literaturën etj.) 2. Raporti i Vlerësimit nga Kolegët, 3. Raporti i Vlerësimit të performancës Individuale (aneksi 6.10) dhe 4. Raporti i Paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit (Aneksi 3.10) <p>Me synim përmirësimin e cilësisë, rritjen dhe zbatimin e standardeve të kërkuara si dhe arritjes së objektivave dhe marrëdhëniet me studentët, të dhënat e përpunuara nga kordinatori i NjsBC u dërgohen fakulteteve përkatëse, (Aneksi 6.9.4) si dhe pedagogëve (Aneksi 6.9.5)</p> <p>Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga aktivitetet e NjsBC përfshihen në përpilimin e Raportin Vjetore mbi ecurinë Akademike të Departamentit Anekse 3.8; 3.9 dhe 3.10).</p>
---	--

	<p>NjSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore aplikon, koordinon dhe finalizon, gjithë procedurën e akreditimeve fillestare dhe periodike si të programeve ashtu dhe institucionale.</p> <p>NjSBC bashkëpunon me ekspertë të jashtëm, të angazhuar pranë UNYT si dhe një konsulent juridik me qëllim përmirësimin e sigurimit të cilësisë si dhe trajnon anëtarët e saj (Aneksi 6.17).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Si dokumenti bazë për sigurimin e cilësisë UNYT shërben Manuali i Sigurimit të Cilësisë për KPSSC (Aneksi 6.1).</p> <p>Procesi për sigurimin e brendshëm sigurohet me mënyra të ndryshme si: petitionet akademike të studentëve, vlerësimi nga studentët, raportet e vetëvlerësimit, vlerësimi i kolegëve nga mbikëqyrësit për çdo profesor. (Aneksi 3.8 dhe 3.9)</p> <p>Në raportet vjetore të NjSBC (Anekset 6.2; 6.2.1; dhe 6.2.2.) vërehet që për Sigurimin e jashtëm të cilësisë, UNYT e realizon nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional dhe programeve në përputhje me standardet dhe rregullat e përcaktuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, standardet evropiane dhe ndërkombëtare. UNYT merr të gjitha masat për të plotësuar maksimalisht rekomandimet e lëna nga vlerësuesit e jashtëm dhe Bordi i Akreditimit.</p> <p>UNYT është riakredituar institucionalisht nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në bazë të <i>vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.61, datë 18.12.2020, akreditim I vlefshëm deri në vitin 2026. (Akreditimin e parë sipas vendimit të Bordit të Akreditimit Nr 102 dt 10/11/2017), (Aneksi 1.28).</i></p> <p><i>Për programin Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri” nuk ka një plan-veprimi për ndjekjen e rekomandimeve nga ASCAL duke qenë se po akreditohet për herë të parë.</i></p> <p>UNYT është në proces akreditimi me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në arsimin e lartë në Turqi “YOKAK”. (<i>UNYT që prej vitit 2018 UNYT ka kaluar në pronësi të Fondacionit Turk Maarif (TMF).</i>)</p> <p>UNYT ka zhvilluar një takim paraprak me prezencë të ekspertëve nga YOKAK, të cilët janë njohur fillimisht me strukturat e universitetit si dhe janë depozituar aktet ligjore kryesore të UNYT. Aneksi 6.11 YÖKAK Visit Agjenda</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore</p>	<p>NjSBC e UNYT bazuar në format e ndryshme të vlerësimit të stafit akademik (nga studentë dhe kolegë) (Anekset 6.9; 6.9.1; 6.9.2; 6.9.3 dhe 6.9.6) gjeneron raporte me të dhëna (Aneksi 1.15), me qëllim evidentimin e pikave të forta dhe evidentimin e pikave të dobëta që ka Institucioni.</p>



<p>institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>NjsBC pasi përfundon hedhjen e të dhënave të pyetësorëve në sistemin SEEvaluation, përpunon raportin përfundimtar dhe bën të njohur me rezultatet e këtij vlerësimi Rektoratin, Dekanët e Fakultetit, Përgjegjësit e Departamentit si dhe rezultati i dërgohet secilit profesor në mënyrë elektronike. (Aneksët 6.9.4 dhe 6.9.5)</p> <p>Drejtuesi i Departamentit përgatit çdo vit Raportin e Paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit në lidhje me komponentën e mësimdhënies dhe të mësuarit për departamentin (Aneksi 1.16).</p> <p>KPSSC në bashkëpunim me NjsBC në bazë të raporteve jep rekomandime/sugjerime për përmirësimin e pikave të dobëta që ka Institucioni.</p> <p>Instrumentet e shumta si pyetësorë me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një feedback-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.</p> <p>UNYT praktikon vlerësimin e profesorëve të rinj nga profesorët më me eksperiencë të fushës, në mënyrë që të mundësojë sugjerime dhe përmirësime në mësimdhënie.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni (UNYT) disponon strukturat për vlerësimin e cilësisë së brendshme, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC). Këto dy struktura bashkëpunojnë në planifikimin e punës për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. NjsBC harton anketa për vlerësimin e stafit nga studentët, kolegët, vetvlerësimin apo dhe vlerësimin dhe promovimin e pedagogëve të rinj. UNJYT përmes mekanizmave të vlerësimit të jashtëm (Institucioni është akredituar dy here nga ASCA), bën përpjekje për rritjen e cilësisë dhe promovimin e programeve të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen</p>	<p>Në qëllim mbikëqyrjes periodike të programeve të studimit, UNYT ka të ndërtuara strukturat, mekanizmat dhe procedurat që zbatohen nga secila njësi për të përmbushur objektivat e programeve, të njësive dhe të universitetit në tërësi.</p>



<p>periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik kërkohet nga Rektorati të vendosen objektivat personale për secilin staf akademik dhe në nivel Departamenti për plotësim përgjatë vitit në vijim. Përgjatë vitit akademik kryhen proceset e nevojshme për përmbushjen e këtyre objektiveve nga të gjithë aktorët e përfshirë në proces. Në përfundim të vitit akademik nga Rektorati kërkohet të përpilohen raporte në nivel Departamenti (Anekset 1.15 dhe 1.16) dhe Fakulteti, ku përshkruhen të gjitha aktivitetet për përmbushjen e objektiveve, kryhet vlerësimi i performancës së stafit akademik dhe analizohet veprimtaria në përmbushje të objektiveve dhe vendoset një plan aksioni për zgjidhjen e problematikave të hasura përgjatë vitit akademik. Ky plan veprim do të përdoret edhe në vitin në vijim si pjesë e objektiveve përmbushëse të Departamentit dhe stafit përkatës.</p> <p>Të gjitha raportet grumbullohen në vijim për të krijuar Raportin Final Institucional (Anekset 3.8 dhe 3.9), i cili miratohet në Senat dhe dërgohet në Ministrinë e Arsimit. I gjithë procesi dokumentohet dhe bëhet transparent tek të gjitha njësitë e përfshira, (Aneksi 1.15.2) duke siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe duke promovuar praktikën e mira dhe arritjet e rezultateve të larta.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>UNYT në mënyrë të vazhdueshme kontakton me studentët me qëllim përmirësimin e programeve të studimit. <i>Për programin Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri” studentët e parë diplomohen për vitin akademik 2023-2024 ndaj s’ka të dhëna.</i></p> <p>Për këtë program studimi, UNYT ka marrë parasysh propozimet dhe komentet e ndryshme në pyetësorët që zhvillohen 2-3 herë gjatë vitit akademik (Anekset 6.9; 6.9.1; 6.9.3 dhe 6.9.6 si dhe komunikimeve të drejtëpërdrejta me studentët me përfaqësim nga grupi i Unionit Studentor, si dhe komunikimeve të vazhdueshme të studentëve me zyrën e pranimeve. Insitucioni merr në konsideratë dhe diskuton me departamentet përkatëse mundësinë për ndryshime eventuale (Anekset 6.9.4 dhe 6.9.5)</p> <p>NJSBC në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit monitoron në mënyrë të vazhdueshme mënyrën se si ofrohet programi i studimit dhe nëse ky program përputhet me Kodin e Cilësisë. Në bazë të performancës së lartë akademike dhe kontributit të tyre, si dhe bazuar në rezultatet e vlerësimeve periodike të studentëve, si dhe vlerësimeve nga ekspertë të fushës për kolegët, UNYT vlerëson stafin akademik duke i promovuar në pozicione si përgjegjës departamenti, kryetar i KPSSC, koordinator i zyrës së alumnit, vlerësim publik duke i akorduar titullin “Profesori më i Mirë i Vitit” etj (Aneks 4.29).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të</p>	<p>Procesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në UNYT përfshin:</p> <p>a) vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënimit nga studentët, si përfituesit kryesor të cilësisë së veprimtarive</p>

<p>studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>mësimore të institucionit (Aneksi 6.9);</p> <p>b) vlerësimin e kolegëve që ndihmon profesorët të kuptojnë pikat e forta dhe të dobëta, mjetet dhe teknikat e tyre për të përfutur të nxënit e studentëve (Aneksi 6.4);</p> <p>c) vetëvlerësimin: një mjet për profesorët që u lejon atyre të reflektojnë mbi strategjinë e tyre të mësimdhënies dhe të ndërmarrin hapa për të përmirësuar (Aneksi 6.10)</p> <p>Raportet vjetore të arritjeve të departamentit (Aneks 1.15 dhe 1.15.1) evidentojnë arritjet dhe adresojnë problematikat për përmirësimin në vitet pasardhëse.</p> <p>Për nxitjen e mësimdhënies UNYT organizon Seminare Akadematike, Procese të Rishikimit të Syllabuseve; Programet e monitorimit, Fakultetet aplikojnë transparencë të vlerësimit çdo semestër për të identifikuar dhe minimizuar paragjykimet e mundshme gjate këtij procesi.</p> <p>UNYT integron cilësinë e mësimdhënies me politikat e mbështetjes së studentëve nëpërmjet Këshilltarit Akademik, Qendrës së Matematikës, Qendrës së Shkrimit, Qendrës së Mbështetjes dhe Këshillimit Akademik, Zyrës së Pranimit të Studentëve, Dekanit të Studentëve, Zyra e Karrieres dhe Alumnit (Aneks 2.4; 2.8; 3.4 dhe 3.2).</p> <p>Në mënyrë të vazhdueshme UNYT ka marrë iniciativa për rishikim të kurrikulave me qëllim përmirësimin e programit të studimit (<i>Programi Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri” nuk i ka rishikuar ende kurrikulat m.q.s studentët e pare i diplomon në vitin akademik 2023-2024</i>), (Aneksi 2.1, tabela 11). Për këtë program studimi, janë zhvilluar disa takime me anëtarët e Departamentit, por nuk janë vënë në zbatim duke qenë se programi nuk ka kaluar akoma akreditimin e parë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të cilësisë dhe performancës së programit të studimit, UNYT përdor instrumenta të tërthorta, me studentë, të diplomuar, staf akademik dhe administrativ. Pas diplomimit ose ndërprerjes së studimeve studentët plotësojnë një anketë dalëse. Këto raporte shërbejnë për dy qëllime: a) vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së pedagogëve; dhe b) përfshirjen e rregullt të studentëve në përmirësimin e programit të studimit. Për <i>Programin Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri” nuk i ka të dhëna konkrete m.q.s studentët e pare i diplomon në vitin akademik 2023-2024</i>.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte të vazhdueshme me diplomuarit e Universitetit te New York-ut si dhe angazhon</p>

<p>studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>vazhdimisht ata në evente të ndryshme që organizon universiteti (Aneksi 5.17 dhe 5.17.1)</p> <p>Vlen të përmendet pjesëmarrja e tyre në panairin e punës që organizohet çdo vit në ambientet e UNYT në muajin Maj me pjesëmarrës nga kompanitë më në zë me qëllim rekrutimin e studentëve të UNYT.</p> <p>(Anekset 5.15; 5.15.1; 5.15.2; 5.16 dhe Aneksi 5.16.1)</p> <p>Gjithashtu, studentët e UNYT kanë marrë pjesë në sondazhin kombëtar të studentëve të organizuar nga ASCAL në 2022 i cili ishte një mekanizëm për matjen e kënaqshmërisë së studentëve në lidhje me cilësinë në arsimin e lartë (Aneksi 6.15).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>UNYT përdor sistemin e trefishtë të vlerësimit të cilësisë: a. vlerësimi i studentëve për pedagogët dhe mesimdhënien, b. vlerësimi i pedagogut nga kolegët, dhe c. vetvlerësimi i pedagogut. Ky sistem është i detajuar në çdo zë, nxjerr në pah problematika dhe adreson çështje që mund të jenë subjekt përmirësimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.4


Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UNYT ka ngritur Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë (KPSSC) (Aneksi 1.1 neni 32), i cili përbëhet nga kryetari dhe 6 anëtarë që përfaqësojnë të gjitha fakultetet dhe studentët. Ky komision mbikëqyr dhe zhvillon rregulloret (Aneksi 6.1 dhe 6.3) politikat, programet, proceset akademike dhe joakademike dhe siguron përputhjen me kuadrin ligjor duke garantuar cilësinë në UNYT në bashkëpunim me të gjithë aktorët, përfshirë dhe ata të jashtëm. Pjesë e strukturës së brendshme për sigurimin e cilësisë është edhe Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Aneksi 6.7) e cila përbëhet nga dy anëtarë të stafit administrative. Strukturat e ngritura dhe procedurat e ndjekura UNYT për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë si dhe me Manualin për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”. UNYT ka angazhuar një ekspert të jashtëm me eksperiencë dhe angazhim të vazhdueshëm në aktivitetet e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (Aneksi 6.5).</p> <p>Këto struktura synojnë monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë në UNYT mbështeten në Manualin e Sigurimit të Cilësisë (Aneksi 6.1) të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 4 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	përpiluar nga anëtarët e KPSSC në bashkëpunim me NjSBC si dhe me ekspertin ligjor në UNYT.
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ konstaton që strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UNYT janë KPSSC dhe NjSBC si dhe eksperti e jashtëm i angazhuar në UNYT. Në Statutin e UNYT (Aneksi 1.1; nenet 32 dhe 33) përcaktohen qartë detyrat konkrete për të gjitha njësitë. KPSSC në bashkëpunim me NjSBC ka hartuar nje rregullore të brendshme për organizimin dhe punën e KPSSC (Aneksi 6.3). Rregullorja e KPSSC është në përputhje Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr. 80/2015, datë. 22.07.2015; Neni 1033 dhe 104, me Statutin e UNYT, Neni 32 dhe 33 dhe Manualin e KoGaSC (Aneksi 6.1). Puna e NJSBC mbështete në një rregullore të posaçme (Aneksi 6.7) të bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr. 80/2015, datë. 22.07.2015. Gjithashtu KPSSC dhe NjSBC harton plan veprimin për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Bordi i Akreditimit për çdo program studimi, në të cilin përcakton përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë kryesore përgjegjëse, individët dhe studentët për përmbushjen e tyre.</p> <p>NJSBC harton çdo fillim viti një plan veprimi i cili bazohet në rregulloren e brendshme të njësisë ku parashtrihen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë vjetor (Anekset 6.16 dhe 6.16.1) si dhe përpilon raportet vjetore bazuar në gjithë informacionet e grumbulluar gjatë punë së një viti (Anekset 6.2; 6.2.1 dhe 6.2.2)</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Siç u konstatua nga GVJ dhe në kriteret e mësipërme KPSSC dhe NjSBC, janë përgjegjëse për çështjet e sigurimit të cilësisë, monitorimin dhe përmirësimin e niveleve të cilësisë. Ato në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve dhe Drejtuesin e Departamentit nëpërmjet përdorimit të një shumëllojshmërie mekanizmesh të tillë si: --përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit (Aneksi 6.9) si përfituesit kryesorë të veprimtarive mësimore të institucionit.</p> <p>-Procesi i vlerësimit të kolegëve i cili ndihmon profesorët për të përmirësuar teknikat e tyre, për të përfutur një proces mesimdhënie sa më efikas ndaj studentëve; (Aneksi 6.4)</p> <p>-procesi i vetëvlerësimit: një mjet për profesorët që u lejon atyre të reflektojnë mbi strategjinë e tyre të mësimdhënies dhe të ndërmarrin hapa për t'u përmirësuar. (Anekset 1.33 dhe 6.10)</p> <p>Fakultetet aplikojnë transparencë ndaj procesit të korigjimeve në mënyrë që çdo semestër të identifikojnë dhe minimizojnë paragjykimet e mundshme në këtë proces. Të gjitha zyrat administrative janë në mbështetje të vazhdueshme me synim përmirësimin e procesit të mësimdhënies.</p>

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>KPSSC zgjidhet nga Senati Akademik përbëhet nga kryetari dhe 6 anëtarë, të cilat përfaqësojnë të gjitha fakultetet dhe studentët. Bazuar në rregulloren e brendshme për organizimin dhe punën e komisionit të përheshëm për garantimin e standardeve të cilësisë dhe për njësimin e sigurimit të cilësisë, ata kanë një mandat dy vjeçar dhe kanë të drejtë për riemërim. (Aneksi 6.3)</p> <p>Në zbatim të Ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", të Statutit të UNYT, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, UNYT ka hartuar Kodin e Etikës. Ky kod garanton shmangien e çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve dhe është i detyrueshëm për zbatim në të gjitha njesitë përbërëse të UNYT përfshirë personelin akademik, administrative dhe studentët Aneksi 3.1 neni 3)</p> <p>Anëtarët e KPSSC dhe NjBSC përbëhen nga anëtarë të stafit akademik, me eksperiencë dhe integritet, gjë e cila shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>UNYT është pjesë si partner në projektin Erasmus +: QAINAL "Mbështetje Strategjike për Forcimin e Strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri". Kjo I ka shërbyer institucionit dhe të gjithë palëve të tij në përmirësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë. UNYT për të rritur sigurimin e brendshëm të cilësisë përdor edhe reagime nga burime të jashtme si komunitetet e biznesit dhe ato profesionale, në të cilat janë punësuar të diplomuarit e UNYT, si dhe të dhëna statistikore mbi normat e punësimit të ofruara nga Zyra e Karrierës dhe Alumni e UNYT dhe studimi i tregut (Aneksi 5.20).</p> <p>UNYT shfrytëzon njohuritë e fituara nga studentët/fakultetet që shkojnë jashtë vendit dhe vendos mënyra për të integruar vlerën e shtuar të studentëve/fakultetit të ardhur në kampus, në mënyrë që të përfitojë nga kjo përvojë për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. (Anekset 5.10; 5.17 dhe 5.17.1)</p> <p>UNYT ka si pjesë aktive të proceseve të vlerësimit të brendshëm edhe ekspertin e jashtëm për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë (Aneksi 6.5).</p> <p>Në kuadër të vlerësimeve periodike të procesit të akreditimit të programeve të studimit, dhe akreditimit Instituciaonal, një vemendje e veçantë i kushtohet sugjerimeve dhe rekomandimeve të lëna nga ekspertët e jashtëm të ASCAL, plan veprimi i cili percillet tek personat përgjegjës dhe ndiqet hap pas hapi nga KPCCS dhe NjSBC. Ky plan-veprimi është edhe pjesë e raportit vjetor të KPCCS dhe NjSBC. (Anekset 6.2; 6.2.1; 6.2.3)</p>

	(Shënim: Programi Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri” studentët e parë i diplomon në vitin akademik 2023-2024 ndaj s'ka statistika për punësim, si dhe aplikon për herë të parë për akreditim)			
Konkluzione	UNYT përfshin të gjithë aktorët e interesuar, studentët, stafin ndihmës dhe stafin akademik në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve. Strukturat përgjegjëse KPSSC dhe NjBSC bashkërendojnë punën me Fakultetet dhe Departamentet për përmirësimin e problematikave të dala nga proceset e vlerësimit. UNYT është Akredituar institucionalisht dy herë nga ASCAL dhe gjatë këtyre proceseve është përpjekur të plotësojë detyrat dhe sygjerimet ekspertëve të jashtëm. UNYT mban lidhje me alumn-it dhe shfrytëzon promovimin e praktikave të mira.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Politikat dhe procedurat në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin dhe Rregulloren e UNYT-së. (Aneksi 1.1; 1.7 dhe 6.1)</p> <p>Statuti i UNYT është publik në Web në linkun si më poshtë: https://unyt.edu.al/index.php/licensing-and-accreditation/#statute</p> <p>NjSBC publikon vazhdimisht rregulloren e Njësise, rregulloren e KPSSC si dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë (në rast të ndryshimit/përditësimit të tyre).</p> <p><i>GVJ konstaton që këto rregullore janë të aksesueshme në faqen e web të UNYT.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>UNYT bën publike në web-in e universitetit të gjitha vlerësimet e programeve si dhe vlerësimin për akreditimin institucional dhe vë në dispozicion të gjitha vlerësimet nga ASCAL.</p> <p>https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fe17a337-53f</p> <p>Vlerësimet e studentëve (anekset 6.9; 6.9.1; 6.92 dhe 6.9.6) përpunohen në mënyrë elektronike dhe konkluzionet si dhe komentet u bëhen publike pedagogëve përkatës pasi lënda të ketë përfunduar plotësisht duke ruajtur konfidencialitetin.</p>

	<p>Drejtuesi i Departamentit si dhe Dekani përkatës informohen në detaje për rezultatet e procesit me mundësinë për të propozuar përmirësime, kur është e nevojshme (Aneksi 6.6). Formulari i vlerësimit nga kolegët nënshkruhet nga pedagogu dhe vlerësuesi, me komente dhe propozime nga të dyja palët. (Aneksi 6.4)</p> <p><i>(Programi Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri” aplikon për herë të parë për akreditim)</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Të gjitha vetëvlerësimet e kryera së bashku me rezultatet e tyre përkatëse për programin, pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit të cilat shoqërohen me një plan veprimi.</p> <p>Çdo vit bazuar në një kalendar të brendshëm Rektorati i kërkon Dekanëve dhe Përgjegjësve të Departamenteve të hartojnë projekt buxhetet e tyre me zëra përkatës duke përfshirë nevoja akademike dhe operacionale të departamenteve, të cilat synojnë rritje akademike, përmirësim të kushteve të mësimedhenies dhe mësimnxenies</p> <p><i>Në Plan buxhetin e Departamentit Dizajn të paraqitur nga GVB, (Aneksi 3.27) GVJ konstaton parashikime për blerje paisjesh (psh printer 3D) që u vijnë në ndihmë studentëve të Programi Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn interieri”; buxhet për blerje literature apo programe kompjuterike, si dhe financime për aktivitete të ndryshme të gjitha në shërbim të përmirësimit të cilësisë së programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UNYT nëpërmjet mekanizmave të ndërtuar ndër vite e të pasuar nga eksperiencia dhe projektet e ndërmarra ka siguruar mbajtje dhe rritje të cilësisë së veprimtarive të veta përfshirë mësimdhenien dhe kërkimin shkencor. <i>(UNYT është akredituar dy herë nga ASCAL)</i></p> <p>Departamentet, Fakultetet si dhe KPSSC she NjBS janë në koherencë për përmbushjen e objektivave si gjithmonë rritjen e cilësisë, vazhdimësinë e programeve, rritjen e numrit të studentëve dhe përmbushjen e misionit të Universitetit.</p> <p>NjSBC harton çdo vit një raport vjetor ku përfshin veprimtarinë që këto struktura kanë ndjekur dhe monitoruar me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë në UNYT si dhe mekanizmat ku mbështeten. (Aneksi 6.2; 6.2.1 dhe 6.2.2).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UNYT ka përdorur metoda të ndryshme për përmirësimin e aktiviteteve të mësimdhenies dhe mësimnxënies si.:</p> <ul style="list-style-type: none"> -duke ftuar ekspertë akademikë dhe joakademikë nga fusha të ndryshme; (Aneksi 1.12) -organizimi i udhëtimeve edukative në terren dhe projekte kërkimore në botën reale, duke eksploruar se si mjediset e të mësuarit mund të bëhen më të favorshme për shkëmbimin e njohurive, informacionit dhe ideve brenda dhe jashtë; (Aneksi 1.11)



	<p>-organizimi i kompeticioneve të ndryshme. (Aneket 1.13 dhe 1.14)</p> <p>Me qëllim njohjen e mekanizmave që UNYT praktikon për përmirësimin e cilësisë janë kryer trajnime të ndryshme nga akademikë me eksperiencë në fushën e sigurimit të cilësisë.</p> <p>Studentët dhe personeli I UNYT si pjesë e trajnimit të kryer nga ASCAL për sondazhin kombëtar të studentëve, kishin mundësi që të informoheshin më gjerë rreth rëndësisë dhe procesit të sigurimit të cilësisë. (Aneket 6.25 dhe 6.17)</p>			
Konkluzione	<p><i>UNYT ndjek politika të qarta për sugurimin e cilësisë. Në faqen e web të universitetit gjenden statuti i UNYT, rregulloret strukturave përgjegjëse si dhe manuali i cilësisë, të aksesueshme për studentët dhe gjithë të interesuarit</i></p> <p><i>UNYT si dhe Departamenti I arkitekturës dhe Dizajnit organizojnë veprimtari të ndryshme për informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve dhe stafit për rritjen e cilësisë së programit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier, të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i New York-ut në Tiranë (UNYT)”


Në përgjithësi, vlerësimi përfundimtar për Programin e Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Dizajn” me profilet “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interieri” në UNYT është POZITIV. Institucioni për këtë program studimi ka arritur të krijojë një ambient të qëndrueshëm akademik dhe financiar për zhvillimin e programeve, duke siguruar që studentët të kenë mundësi të shumta për zhvillim profesional dhe akademik.

Pika të forta dhe afirmime:

1. Stafi i fakultetit është i kualifikuar dhe i kalibrit ndërkombëtar.
2. Stafi ka qenë në rritje krahasuar me vitin e hapjes.
3. Godina e re është ndërtuar me parametra bashkëkohore dhe materiale cilësore, me ambiente të kondicionuara dhe të mirëndriçuara, duke krijuar kushte optimale për studentët dhe stafin.
4. Laboratorë të kompletuar.
5. Mësimi në gjuhën angleze u ofron studentëve mundësi më të mëdha për tregun e punës brenda dhe jashtë vendit.
6. Aplikimi i bursave për maturantët me rezultate të larta.
7. Mësimi në gjuhën angleze ofron mundësi për studentët e huaj të interesuar të ndjekin studimet në këtë universitet.
8. UNYT ka marrëveshje të shumta me grupe biznesi që mund të jenë punëdhënës potencialë për të diplomuarit e këtij universiteti.
9. UNYT ka vënë në dispozicion të studentëve sistemin antiplagjaturë Turnitin, duke ndihmuar që punimet e tyre të jenë cilësore dhe origjinale.
10. UNYT nxit dhe mbështet stafin akademik dhe studentët në promovimin e tyre.
11. UNYT ka struktura të posaçme për instruktimin dhe këshillimin e studentëve, nga hyrja deri në diplomim e më tej.

Pika të dobëta:

1. Një tjetër mangësi e rëndësishme është mungesa e një laboratorit dhe hapësirave të dedikuara për printime dhe prodhime materiale, duke u mbështetur në Standardin IV.2, Kriteri 3.
2. Dega e Dizajnit po zhvillohet me ritme të shpejta, është thelbësore që biblioteka të pajiset me literaturë më specifike dhe të përshtatur për profilet e ndryshme të dizajnit, në përputhje me Standardin II.4, Kriteri 5.



Rekomandime:

1. Institucioni, të rrisë promovimin e këtij programi studimi, me qëllim rritjen e numrit të studentëve në këtë program.
2. Përditësimi i Bibliotekës: Përditësoni rregullisht koleksionin e bibliotekës me materiale dhe libra të rinj që përmbushin nevojat specifike të programeve të studimit, duke përfshirë risitë dhe zhvillimet më të fundit në fushën e dizajnit dhe arkitekturës dhe sidomos në fushën e Dizajnit për të cilën ka dhe më shumë mangësi. Standardin II.4, Kriteri 5.
3. Institucioni të investojë në krijimin e një laboratorit të dedikuar printimeve dhe prodhimeve materiale, duke u mbështetur në Standardin IV.2, Kriteri 3.

Conclusions from the Evaluation of the Bachelor Study Program in "Design" with the profiles "Graphic Design" and "Interior Design," offered by the Higher Education Institution "University of New York (UNYT)"

Strengths and Affirmations:

1. The faculty staff is qualified and of international caliber.
2. The staff has grown compared to the year of its establishment.
3. The new building is constructed with modern standards and high-quality materials, with air-conditioned and well-lit spaces, creating optimal conditions for students and staff.
4. Fully equipped laboratories.
5. Teaching in English provides students with greater opportunities in the job market both domestically and abroad.
6. Scholarship applications for high-achieving high school graduates.
7. Teaching in English offers opportunities for foreign students interested in pursuing studies at this university.
8. UNYT has numerous agreements with business groups that can be potential employers for its graduates.
9. UNYT has made the Turnitin anti-plagiarism system available to students, helping to ensure their work is of high quality and original.
10. UNYT encourages and supports the academic staff and students in their professional development.
11. UNYT has dedicated structures for student guidance and counseling, from admission to graduation and beyond.


Weaknesses:

1. Another significant shortcoming is the lack of a laboratory and dedicated spaces for printing and material production, as supported by Standard IV.2, Criterion 3.
2. Since the Design department is developing at a rapid pace, it is essential for the library to be equipped with more specific literature tailored to the various design profiles, in accordance with Standard II.4, Criterion 5.



Recommendations:

1. The institution should enhance the promotion of this study program to increase the number of students in this program.
2. Library Update: Regularly update the library collection with new materials and books that meet the specific needs of study programs, including the latest innovations and developments in the fields of design and architecture, especially in the area of Design, where there are still significant deficiencies. This aligns with Standard II.4, Criterion 5.
3. The institution should invest in the creation of a dedicated laboratory for printing and material production, in accordance with Standard IV.2, Criterion 3.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

